

FORUM SA PRIVATA SA BEMETE  
KONJA BOKITE FORUM




Center  
for Civic  
Initiative



Центар за  
граѓанска  
иницијатива

# PROJEKT PËR PËRKRAHJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT



RAPORT PËR  
PERIUDHËN  
2004/2005

**PROJEKT PËR PËRKRAHJEN E  
TË DREJTAVE TË NJERIUT**

**RAPORT PËR PERIU DHËN**

**2004 - 2005**

**Autor:** Petar Jordanoski

**Botues:** Koalicioni "Të gjithë për gjyqime të drejta" - Shkup  
ARKA-Forumi për të drejtat e romëve - Kumanovë  
Qendra për Zhvillim demokratik - Tetovë  
IZBOR - Strumicë  
Qendra për iniciativë qytetare - Prilep

**Redaktor:** Petar Jordanoski

**Përgatitje grafike:** RI-Grafika - Shkup  
tel./x: (02) 2451-527  
e-mail: rigrafika@mt.net.mk

**kopertina:** PROMODSGN

**Përkthim:** Norik Selimi

E Perkohur nga



Organization for Security and Co-operation in Europe  
**Spillover Monitor**  
**Mission to Skopje**

---

Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të thotë se e përfaqëson këndvështrimin dhe qëndrimin e Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup.

---

# *Përmbajtja*

<b>Rezyme e shkurtë</b>	<b>7</b>
<b>Hyrja</b>	<b>9</b>
<b>1. Takime lokale koordinuese- Forma bashkëpunimi ndërmjet PPDNJ dhe organeve shtetërore</b>	<b>11</b>
<b>2. Janë evidentuar raste të shpërdorimit nga ana e policisë në kuadër të PPDNJ</b>	<b>13</b>
<b>3. Struktura etnike, e moshës, dhe gjinore e të quajturave viktima</b>	<b>17</b>
<b>4. Lloji i nëpunësve të autorizuar të involvuar në rastet e regjistruara gjatë PPDNJ</b>	<b>19</b>
<b>5. Paraqitja e parashtresave në SKBSP të MPB</b>	<b>23</b>
- Hyrje	23
- Paraqitja e parashtresave në SKBSP	23
- Statusi i parashtresave të paraqitura në SKBSP nga OJQ-të të cilat e implementojnë PPDNJ	25
- Kërkesa për njoftime drejtuar SKBSP	26
- Parashtresa të cilave SKBSP ende nuk u është përgjigjur	26
- Rezultatet nga parashtresat e paraqitura në SKBSP	27
- Korniza ligjore	27
- Rezultatet nga parashtresat në rastet në kuadër të PPDNJ	28
- Si ndëshkohen PAZ të MPB të cilët shkelin të drejtat e njeriut	31
<b>6. Paraqitja e parashtresave Avokatit të popullit</b>	<b>35</b>
- Kompetenca e Avokatit të popullit	35
- Paraqitja e parashtresës Avokatit të popullit	35
- Statusi i parashtresave që i janë paraqitur avokatit të popullit	36

<b>7. Sthurja e rasteve të PPDNJ prej paraqitjes së denoncimit penal e deri te ngritja e aktakuzës</b>	<b>39</b>
- Korniza ligjore	39
- Rezultati nga denoncimet penale të paraqitura në Prokurorinë publike	40
<b>8. Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të</b>	<b>43</b>
<b>9. Procedura civile për kompensim të dëmit</b>	<b>45</b>
<b>10. Vërtetime mjekësore dhe dëshmi të tjera në rastet e eventuale të shpërdorimit policor</b>	<b>47</b>
<b>11. Konkluzione të raportit përfundimtar</b>	<b>49</b>
<b>12. Objekt i brengosjes</b>	<b>51</b>
<b>13. Rekomandime të raportit përfundimtar</b>	<b>52</b>

---

### *Lista e shkurtesave të përdorura më shpesh*

ARKA	Forumi për mbrojtjen e të drejtave të romëve
Koalicioni	Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta"
QIQ	Qendra për iniciativë qytetare
QZHD	Qendra për zhvillim demokratik
OSBE MVSH	Organizata e sigurisë dhe bashkëpunimit në Evropë, Misioni vëzhgues në Shkup
PPDNJ	Projekti për përkrahjen e të drejtave të njeriut
MPB	Ministria e punëve të brendshme
SKBSP	Spektori i kontrollit të brendshëm dhe i Standardeve profesionale
PPTH	Prokuroria publike themelore
AP	Avokati i popullit
KP	Koordinator i projektit
OP	Oficer i projektit
KEDNJ	Konventa evropiane për të drejtat e njeriut
OJQ	Organizata joqeveritare
PAZ	Person i autorizuar zyrtar
LPP	Ligji për procedurë penale
KP	Kodi penal



---

## *Rezime e shkurtë*

Projekti për përkrahjen e të drejtave të njeriut (PPDNJ) është një iniciativë e ndërmarrë nga shoqëria civile që përqendrohet në fenomenin e keqpërdorimit dhe keqtrajtimit policor. Projekti ka për qëllim të adresojë përdorimin ilegal të forcës fizike apo mendore nga personat e autorizuar të Ministrisë për punë të brendshme gjatë detyrave të tyre zyrtare, si dhe të ndihmojë në zhvillimin e mekanizmave efektivë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të quajturave viktime.

Me përkrahje financiare nga OSBE – Misioni vëzhgues në Shkup dhe i implementuar nga 5 OJQ, PPDNJ mbulon tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Si rezultat i aktiviteteve të projektit që janë zbatuar mes vitit 2004 dhe 2005, ky Raport është zhvilluar me përdorimin e gjetjeve nga rastet e evidentuara të keqtrajtimit dhe keqpërdorimit policor. Raporti jep një fotografi krahasuese të nivelit të respektimit të të drejtave të njeriut nga Ministria e punëve të brendshme, dhe masat preventive të ndërmarra nga Institucionet kompetente.

Në këtë Raport, vëmendje e posaçme u është kushtuar mekanizmave ligjor për mbrojtjen e viktimave nga keqpërdorimi policor, dhe pjesërisht nga Sektori për kontroll të brendshme dhe standarde profesionale (SKBSP), trupi i brendshëm për kontroll në suaza të MPB-së. Rezultatet tregojnë se puna e SKBSP shpeshherë prolongohet dhe është joefikase: në kohën që SKBSP ka dhënë përgjigje në 66% ankesa të rasteve të PPDNJ, në pothuajse të gjitha rastet – 97%, përgjigja është dhënë pas afatit prej 30 ditëve të caktuar me Rregulloren për Punë të SKBSP-së.

Më tutje, në mbi 78% të rasteve SKBSP ka konstatuar se personat e policisë në fjalë nuk kanë tejkuluar autorizimet e tyre siç është thënë në fletëparaqitjet. Prej 10 rasteve ku SKBSP ka konstatuar se policët në fjalë janë të fajshëm, vetëm në 3 kanë vazhduar me masa disiplinore – dënim me 15% të rrogës për periudhë të shkurtë – dhe vetëm në një rast janë ngritur akuza penale (polici në fjalë momentalisht është në gjykim në lidhje me akuzë për torturë)

OJQ-të e PPDNJ-së po ashtu kanë përcjellë punën e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe kanë rekomanduar se përdorimet më të madha janë bërë në suaza të dispozitave të parapara me ligj, duke përfshirë edhe përdorimin e medieve në raste të caktuara. Sidoqoftë, është konstatuar se hapja e gjashtë zyrave rajonale të Avokatit të Popullit ka përmirësuar dukshëm qasjen e të quajturave viktime të keqpërdorimit policor ndaj këtij trupi për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Raporti jep një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave gjatë kontakteve të tyre me të autorizuar nga MPB. OJQ-të e PPDNJ-së kanë konstatuar se mekanizmat e brendshme për kontroll të zyrtarëve të MPB-së nuk janë as transparent, as të saktë në kohë, as efikas dhe as objektiv.

Derisa raporti rekomandon një numër të masave për të përmirësuar punën e SKBSP-së, OJQ-të e PPDNJ-së besojnë se Qeveria e Maqedonisë duhet të konsiderojë formimin e një trupi të jashtëm, të pavarur i cili do t'i shqyrtojë ankesat. Kësi soj trupi do të ishte në përputhje me standardet sipas Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut



---

# *Hyrje*

Në janar të vitit 2004 Tre organizata joqeveritare aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut filluan implementimin e projektit për Përkrahjen e të drejtave të njeriut (në tekstin e mëtejshëm i quajtur si PPDNJ). Qëllimi kryesor ishte që tu sigurohet këshillim dhe ndihmë juridike falas të quajturave viktime të sjelljes jo të drejtë të policisë, të cilët kërkojnë ndihmë në paraqitjen e ankesave zyrtare përmes mekanizmave të ndryshme administrative dhe juridike që i kanë në disponim. Fillimisht projekti ishte implementuar në rajonet e Tetovës, Shkupit dhe Kumanovës, si përgjigje ndaj numrit të shtuar të rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut në rajonet e krizës nga ana e policisë. Vëzhgimet e OJQ-ve nacionale dhe organizatave ndërkombëtare që i ndjekin ankesat e qytetarëve për shkeljen e të drejtave të njeriut në disa vite të kaluara, nxorën në pah nevojën e vendosjes së një projekti të këtillë. Të njëjtët kanë vërejtur se viktimat shpesh herë i konsiderojnë procedurat ankimore si të ndërlikuara, frikësuese, të ngadalshme, frustuese, të shtrenjta dhe nga ndonjë herë si të pasuksesshme. Projekti është i financuar dhe përkrahur nga Misioni vëzhgues u OSBE-së në Shkup (në tekstin e mëtejshëm i emëruar si OSBE).

Rajoni i Tetovës ishte mbuluar nga Qendra e zhvillimit demokratik (QZHD), Qendra informative për shoqëri civile (QISHC) mbulonte rajonin e Shkupit, kurse Forumi për të drejtat e Romëve ARKA në Kumanovë. Edhe krahas kësaj, këto tre organizata joqeveritare regjistruan raste të sjelljes jo në rregull nga policia e Kriva Pallankës, Shtipit, Probishtipit dhe Strugës. Në projekt ishin të kyçur gjashtë oficerë projekti, nga dy prej çdo OJQ të lartpërmendura. Oficerët e projektit i ndjekshin rastet e keqpërdorimit të mundshëm policor të cilat i regjistruan gjatë zbatimit të projektit, si dhe rastet që u morën në rishqyrtim nga OSBE, si dhe misionit të PROKSIMËS.

Në suaza të këshillimit juridik pa pagesë, oficerët juridik të kyçur në këtë projekt i ndërmorën këto aktivitete:

- Intervistim dhe dokumentim të gjetjeve
- Fotografim i lëndimeve dhe dëshmive tjera
- Ndihmë për të lënduarit të nxjerrin dokumentacionin e nevojshëm për lëndimet
- Mbledhje e dokumentacionit plotësues shtesë
- Përcjellje e informatave për rastin tek organizatat ndërkombëtare
- Dhënie e këshillave për mjetet juridike të cilat i kanë në disponim viktimat e mundshme, duke përfshirë edhe parashtrimin e supozimeve tek Sektori i MPB-së për Kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, Zyra e Avokatit të Popullit, Prokuroria Publike, si dhe padi private

- Ndhimë për viktimat e mundshme për përgatitjen e letrave, ankesave dhe parashtrimeve deri tek institucionet e lartpërmendura
- Bashkëngjitje dhe/ose përfaqësim të viktimave të mundshme në takimet me bashkëpunëtorët e institucioneve shtetërore
- Sigurimi i mjeteve për rastet sociale, për mbulimin e shpenzimeve për nxjerrjen e dëshmimeve mjekësore (risi në projekt që u shtua në vitin 2005)

### **Implementimi i projektit në vitin 2005**

Ecja e suksesshme e Projektit vazhdoi edhe në vitin 2005, me inkuadrimin e dy organizatave të reja: IZBOR-nga Strumica për rajonin e Maqedonisë jug-Perëndimore dhe Qendra për Iniciativë Qytetare (QIQ) nga Prilepi për rajonin e Maqedonisë jug-perëndimore. Në vitin 2005 rajonin e Shkupit e mbulonte Koalicioni Të gjithë për gjyqime të drejta, në vend të QISHC, e cila doli nga projekti. Me këtë PPDNJ tërësisht e mbulon territorin e Maqedonisë. Vazhdimi i PPDNJ në vitin 2005 është shënuar me trendin e përforsimit të koordinimit mes organizatave joqeveritare të kyçura në projekt dhe marrja e rolit udhëheqës, të cilin në vitin 2004 e kishte OSBE. Respektivisht, në vitin 2005, janë vendosur dy organe të reja në suaza të PPDNJ të karakterit ekzekutiv: Bordi Ekzekutiv dhe Koordinatori i Projektit. Me këtë edhe formalisht vendoset rrjeti i pesë OJQ-ve që punojnë në rastet e keqpërdorimit eventual policor. Me vendosjen e rrjetit të OJQ-ve rritet forca e shoqërisë civile me qëllim të ballafaqimit më efikas me mangësitë e shoqërisë dhe i njëjti bëhet promotor më i fuqishëm dhe më efikas i kauzës së të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2005, roli i OSBE-së është sjellë në Ad Hoc monitorim të aktiviteteve që ndërmerren në kuadër të PPDNJ, në organizimin e trajnimeve për forcimin e kapaciteteve të OJQ-ve, për planifikim strategjik të rrjetit të OJQ-ve si dhe për rritjen e nivelit të diturisë të këshilltarëve juridik në sferën e të drejtave të njeriut. Gjithsesi, projekti edhe gjatë vitit 2005 pati përkrahje financiare nga misioni i OSBE-së.

Njëra prej risive më të rëndësishme e njëherësh edhe arritje më e madhe e projektit janë takimet e rregullta koordinuese që organizohen nga çdo OJQ në nivel lokal, në baza mujore. Qëllimi i këtyre takimeve është ndjekja e rasteve eventuale, si dhe përmirësimi dhe forcimi i marrëdhënieve të punës ndërmjet organizatave që marrin pjesë në projekt dhe të institucioneve shtetërore.

Raporti përfshin rastet e regjistruara në periudhën prej 1 janar 2004 deri në 31 tetor 2005<sup>1</sup>. Konkluzionet dhe rekomandimet e raportit kanë për qëllim formulimin e propozimeve për reforma adekuate politike dhe ligjdhënëse të mbështetura në analizat dhe konstatimet sipas projektit, adresimin e të njëjtëve në institucionet adekuate të vendit si dhe evitimin e dobësive dhe lëshimeve në implementimin e deritanishëm të PPDNJ për shkak të vetëpërmirsimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të projektit.

---

<sup>1</sup>Raportin e ka përgatitur Koordinatorin e Projektit PPDNJ

# 1

## ***Takime koordinatave lokale- formë bashkëpunimi midis PPDNJ dhe organeve shtetërore***

Duke filluar nga muaji prill i vitit 2005 në zyrat e çdonjërës nga 5 OJQ të cilat implementojnë PPDNJ, organizohen takime lokale koordinatave. Pjesëmarrës në këto takime janë: inspektorë nga Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale (SKBSP), përfaqësues të Zyrës së Avokatit të popullit, përfaqësues të Prokurorisë publike dhe të vetëqeverisjes lokale si dhe përfaqësues të misionëve të OSBE-së dhe PROKSIMA-s në Maqedoni.

Këtyre takimeve u paraprinë takimet koordinatave që i organizuan zyrat e terrenit të OSBE-së në Kumanovë dhe në Tetovë. Gjatë vitit 2004 dhe 3 muajt e parë të vitit 2005 janë mbajtur 13 takime koordinatave në zyrën e terrenit të OSBE-së në Kumanovë dhe 4 takime në zyrën e terrenit të OSBE-së në Tetovë. Përmes këtyre takime që organizohen në baza mujore mundësohet ndjekje direkt dhe efektive të rasteve të regjistruara të keqpërdorimit policor.

Moderatorë të takimeve koordinuese lokale janë oficerë të projektit PPDNJ të cilët njëherësh edhe i organizojnë. Në të vërtetë në këto takime oficerët e projektit i prezantojnë rastet e reja dhe hapet diskutim me inspektorët e SKBSP dhe me përfaqësuesit e zyrës së Avokatit të popullit për hapat që janë ndërmarë në suaza të PPDNJ në lidhje me rastet e regjistruara të të quajturave viktime të sjelljes jo në rregull të policisë.

Edhe pse ishte paraparë këto takime të mbahen në baza mujore nga fundi i prillit 2005 deri në fillim të nëntorit 2005 janë mbajtur nga 3 takime koordinuese lokale në Kumanovë, Shkup dhe Tetovë dhe nga 2 takime në Strumicë dhe Prilep. Arsytet pse nuk është më i madh numri i takime të mbajtura mund të ndahen në dy grupe:

- Numri i pamjaftueshëm i rasteve të regjistruara në periudhë prej një muaji dhe
- Angazhimi i tepërt i përfaqësuesve të sektorit të MPB dhe të zyrës së Avokatit të popullit.

Prej procesverbaleve nga takimet e mbajtura koordinatave lokale që i dorëzohen koordinatorit të projektit si dhe nga prania e tij në disa nga këto takime, fitohet përshtypja se këto takime kanë domethënie të madhe në procesin e shpejtimin të procedurave që zhvillohen në lidhje me parashtresat e paraqitura në SKBSP dhe në zyrën e Avokatit të popullit. Si shembull mund të merret SKBSP-ja. Duke marrë parasysh numrin e të punësuarve të ngarkuar për të vepruar lidhur me parashtresat e qytetarëve për veprime jo në rregull nga ana e PAZ të MPB mbetet e njëjtë kurse numri i parashtresave nga qytetarë është shtuar shumëfish (1300 gjatë vitit 2004), objektivisht nuk ka mundësi tu përgjigjet pjesës më të madhe të parashtresave në afatin e përshkruar me ligj, prej 30 ditë.

Shpeshherë për përgjigje nga SKBSP pritet me muaj. Nëse zhegitet veprimi rreth parashtresës së paraqitur nga PDNJ për ndonjë rast, inspektorët e MPB do të gjendeshin në situatë mjaft të pavolitshme që në disa takime vijuese (takimet mbahen në baza mujore) të japin përgjigje se nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për ndonjë parashtresë të caktuar. Përmes takimeve përmirësohet qasja dhe besimi i qytetarëve në këta institucione të shtetit e aq më tepër forcohet lidhja paraprakisht e vendosur ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve të shtetit të cilat pranojnë ankesa për të quajturat shkelje të të drejtave të njeriut.

Vlen të përmendet fakti se në trajnimet për oficerë të projektit në PPDNJ marrin pjesë përfaqësues të SKBSP-së, të Zyrës së Avokatit të popullit si dhe përfaqësues të pushtetit gjyqësor dhe të Prokurorisë publike. Deri më tash janë mbajtur dy trajnime të tilla, i pari në dhjetor 2003 kurse i dyti në mars 2005 në Shkup.

### **Konkluzione:**

- Nëpërmjet takimeve lokale koordinatave mundësohet ndjekja e drejtpërdrejtë efektive e rasteve të regjistruara të keqpërdorimit policor;
- Nëpërmjet takimeve lokale koordinatave përmirësohet qasja e qytetarëve në institucionet e shtetit dhe forcohet lidhja paraprakisht e vendosur në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve të shtetit të cilat pranojnë ankesa për të quajturat shkelje të të drejtave të njeriut;
- Këto takime kanë rëndësi të madhe në procesin e shpejtimit të procedurave që zhvillohen përkitazi me parashtresat e paraqitura në SKBSP dhe në Zyrën e Avokatit të popullit.

### **Rekomandime:**

- Mbajtja e rregullt e takimeve lokale koordinatave një herë në muaj në vitin 2006 me qëllim të thellimit dhe intensifikimit të bashkëpunimit të PPDNJ-së, OJQ-ve dhe institucioneve shtetërore që pranojnë ankesa për të quajturat shkelje të të drejtave të njeriut.

## 2

## *Raste të evidentuara të keqpërdorimit policor në kuadër të PPDNJ*

Që në fillim vlen të përmendet fakti se sivjet tërë territori i Republikës së Maqedonisë është mbuluar me PPDNJ. Duke pasur parasysh se njëra prej rekomandimeve të Raportit preliminar për vitin 2004 ishte përfshirja e OJQ-ve aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut përkatësisht zgjerimi i projektit në rajonet ku ekziston nevojë reale për këtë, mund të konstatohet se me përfshirjen e OJQ-ve QIQ nga Prilepi dhe IZBOR nga Strumica në PPDNJ është evituar njëra prej mangësive më të mëdha të regjistruara vitin e kaluar. Me këtë është siguruar një mbulim i Maqedonisë prej 85%. Sido që të jetë, në mbledhjen e Bordit ekzekutiv të PPDNJ më 4 maj 2005 u mor vendim që 15% të territorit të pambuluar të Republikës së Maqedonisë, të mbulohej nga të pesë OJQ-të që e implementojnë PPDNJ. Me këtë PPDNJ nuk është i përkufizuar vetëm në ish rajonet e krizës siç ishte paramenduar dhe implementuar gjatë vitit 2004. Njëherësh me këtë mundësohet një pasqyrë e gjithanshme e problemeve lidhur me rastet e keqpërdorimit policor në nivel nacional.

**Tabela 1: Raste të evidentuara të keqpërdorimit policor**

OJQ	Raste të ndjekura nga OSBE	Raste të iniciuara nga OJQ	Raste të ndjekura nga Organizata Ndërkombëtare	Raste të evidentuara	Raste të mbyllura	Raste aktive
ARKA	5	22	2	29	10	19
Koalicioni	7	21	7	35	11	24
QZHD	5	11	1	17	1	16
IZBOR	0	13	0	13	5	8
QIQ	2	3	1	6	0	6
<b>Gjithsej</b>	<b>19</b>	<b>70</b>	<b>11</b>	<b>100</b>	<b>27</b>	<b>73</b>

OJQ-të të cilat e implementojnë PPDNJ përfundimisht me 31 tetor 2005 kanë evidentuar gjithsej 100 raste të tejkalimit të autorizimeve nga ana e policisë ose veprim të keq që në raport me 39 rastet e evidentuara në vitin 2004, paraqet rritje të numrit të rasteve të regjistruara për 156,4%.

Në implementimin e gjertanishëm të Projektit **ARKA** ka regjistruar 29 raste. Prej tyre 10 raste janë mbyllur: njëri prej rasteve që mbyllur sepse fjala është për rast që është përfshirë me Ligjin e amnistisë kurse rasti tjetër sepse të quajturat viktime të evidentuara nuk kanë dashur ta paraqesin ankesën. \* rastet e tjera janë mbyllur sepse Sektori, Avokati i popullit dhe Prokuroria publike kanë konfirmuar se nuk ka rast të keqpërdorimit policor, kurse të quajturat viktime nuk kanë qenë të interesuara të ngrenë padi private. 19 rastet e tjera janë

aktive. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, 5 janë bartur nga OSBE-ja, 2 raste janë transferuar nga PROKSIMA, kurse 22 rastet e tjera janë të iniciuara nga vetë ARKA. Prej 11 rasteve të regjistruara në këtë vit, 9 janë të vetinicuara.

Oficerët e projektit zë **Koalicionit “Të gjithë për gjykime të drejta”** kanë regjistruar 35 raste, 11 prej tyre janë të mbyllura. Në të vërtetë në rastin e parë njëra prej viktimave nuk ka qenë e interesuar që të vazhdojë procedurën e filluar, në rastin e dytë viktimja nuk ka dashur ta dorëzojë ankesën sepse është frikuar se me ankesën e vet do ta provokonte policinë kurse në rastin e tretë të quajtura viktimja ka vdekur. Vendimi për mbylljen e rastit të tretë është marrë nga O.P. (Oficerë projekti) të cilët e mbulojnë rajonin e Shkupit. Në koordinim me OSBE-në rasti i katërt është mbyllur për disa arsye: e quajtura viktimë nuk ka pasur vullnet që të paraqesë parashtresa në SKBSP, nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme, por gjithashtu pala ka preferuar që rastin ta udhëheq PROKSIMA.

Në tre nga rastet, të quajturat viktimja të cilat janë të regjistruar si persona në narko-varësi kanë refuzuar të nxjerrin vërtetime mjekësore ndonëse u është thënë se harxhimet për ato vërtetime do tu kompensohen. Aq më tepër se të quajturat viktimja kanë dhënë deklarata konfuze sa u përket kryerësve eventual të shkeljeve dhe sa përket vendit ku janë kryer. Nuk janë nxjerr kurrfarë dëshmitarësh e as dëshmi materiale. Njëri prej rasteve është mbyllur ngase, pas marrjes së përgjigjeve rreth parashtresave të paraqitura në SKBSP dhe në Zyrën e Avokatit të popullit dhe pas konsultimeve me viktimën eventuale OP të Koalicionit kanë konstatuar se të drejtat e viktimës janë shkelur nga Policia. Përgjigja negative përkitazi me parashtresat e paraqitura, nga Zyra e Avokatit të popullit dhe SKBSP, si dhe fakti se është dorëzuar vërtetim i rrejshëm mjekësor nga pala, është arsye për mbylljen e njërit prej rasteve. Një rast tjetër i regjistruar është mbyllur pasi është marrë përgjigje negative respektivisht është konstatuar nga Zyra e Avokatit të popullit, në lidhje me parashtresën e paraqitur, se bastisja ka qenë legale. Pala nuk ka qenë e interesuar që ta vazhdojë procedurën. Një rast është mbyllur pas përgjigjes së dhënë gojarisht nga inspektorët e SKBSP se është dhënë i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për gjësendet e marra, respektivisht nuk ka shkelje të së drejtave. Të quajtura viktimja nuk ka qenë e interesuar për të vazhduar procedurën sepse ndërkohë gjësendi i marrë i është kthyer.

Do të thotë në Koalicion ka 24 *raste aktive*. Nga një të pestat e numrit të përgjithshëm të rasteve të Koalicionit, përkatësisht 7 raste janë përcjellë në OSBE dhe 7 në PROKSIMA. 21 rastet e mbetura janë të vetinicuara nga OJQ-të 13 prej 21 rasteve të regjistruara këtë vit janë të vetinicuara nga Koalicioni.

**QZHD** kanë regjistruar 17 raste. Një rast është përcjellë tek QIQ kurse një rast tjetër është mbyllur sepse nuk kanë ekzistuar baza ligjore për ndërmarrjen e hapave juridike në suaza të PPDNJ. 15 rastet tjera janë aktive. 5 raste janë përcjellë nga OSBE-ja një është transferuar prej PROKSIMA-s kurse 11 të tjerat janë të vetinicuara nga QZHD. Nga rastet e regjistruara në vitin 2005 një është përcjellë prej OSBE-së një prej PROKSIMA-s kurse 9 janë të vetinicuara.



Rasti **TE006** është mbyllur sepse janë shterur të gjitha mjetet juridike në suaza të PPDNJ, dhe asnjë nga organet e lartpërmendura nuk ka menduar se ka shkelje të të drejtave të viktimës eventuale.

OJQ-ja e re që u bashkëngjit në PPDNJ- **IZBOR** nga Strumica ka regjistruar 13 raste të sjelljes jokorrekte të policisë. 5 nga këto raste janë mbyllur. Në të vërtetë, është marrë përgjigje negative prej SKBSP-së kurse në përgjigjet e Avokati i popullit në 2 nga këto 5 raste, në shpjegimin e vendimit është shënuar se policia gjatë kryerjes së obligimeve të veta ligjore, duhet të respektojë dinjitetin njerëzor. Ndoshta përfitim më i madh në rajonin e Strumicës në implementimin e PPDNJ është fakti se të pesë viktimat e regjistruara eventuale, mendojnë se pas dërgimit të parashtrësave në Sektorin dhe te Avokati i popullit, sjellja e policisë ndaj tyre është ndryshuar pozitivisht, respektivisht tani policët i respektojnë të drejtat dhe liritë e të quajturave viktima. Po ashtu 13 rastet e IZBOR-it janë të vetinuara.


**QIQ** ka regjistruar 6 raste në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë që e mbulon. Në Prill rasti **TE005** që është transferuar në kompetencë të QIQ dhe e merr shenjën **PP001**, duke marrë parasysh mbulimin territorial të Maqedonisë nga OJQ-të e PPDNJ. Të gjitha rastet që i zhvillon OP i QIQ-it janë aktive. Një nga 3 rastet është bartur nga PROKSIMA, kurse 2 janë transferuara nga OSBE-ja. Tre rastet e tjera janë të vetinuara.

Nga implementim i deritanishëm i projektit mund të konstatohet se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, të quajtura viktima të sjelljes jo të drejtë të policisë, u drejtohen oficerëve të projektit të PPDNJ duke kërkuar ndihmë juridike dhe këshilla, ndërkaq të njëjtën frikohen që të iniciojnë procedurën kundër PAZ të MPB-së.

OJQ-të që e implementojnë PPDNJ-në, përfundimisht me 31 tetor 2005 kanë regjistruar 100 raste të tejkalimit të autorizimeve nga ana e policisë ose veprim të keq. Prej tyre 70 janë të vetinuara nga OJQ-të, 19 janë bartur nga OSBE-ja kurse 11 nga PROKSIMA. 27 prej rasteve janë të mbyllura, kurse 73 të tjerat janë aktive.

Vlen të përmendet se prej 39 rasteve të regjistruara gjatë vitit 2004, 23 janë identifikuar nga vetë OJQ-të të cilat e implementojnë PPDNJ-në, përkatësisht kjo paraqet 59 % të numrit të përgjithshëm të rasteve. Në vitin 2005 janë regjistruar 61 raste prej të cilave 47 të identifikuar përkatësisht 77,1% nga numri i rasteve. Kjo shpie në përfundimin se OJQ-të në PPDNJ gjithnjë e më tepër vetë i identifikojnë rastet e keqpërdorimit policor

### Mënyrat e identifikimit të rasteve në kuadër të PPDNJ



#### Konkluzione:

- Në vitin 2005 është arritur mbulim i tërësishëm i Republikës së Maqedonisë nga PPDNJ me përfshirjen e dy OJQ-ve të reja aktive në fushën e të drejtave të njeriut me çka është arritur një qasje e njëjtë në shërbimet që i siguron projekti për të gjithë qytetarët;
- Numri i rasteve të regjistruara të keqpërdorimit policor dhe të sjelljes jo të drejtë të policisë në kuadër të PPDNJ arrijnë 100, që në raport me 39 rastet e evidentuara në vitin 2004, paraqet një rritje të numrit të rasteve të regjistruara për 156,4%;
- 5 të quajtura viktima të regjistruara në rajonin e Strumicës konsiderojnë se pas paraqitjes së parashtrësave në Sektorin i MPB-së dhe te Avokati i Popullit, sjellja e policisë ndaj tyre është ndryshuar në kuptimin pozitiv, përkatësisht pas inicimit të procedurës policët kanë respektuar të drejtat dhe liritë e të quajturave viktima.

#### Objekt i brengosjes:

- Një numër i konsiderueshëm qytetarësh, të quajtura viktima të sjelljes jo në rregull të policisë, u drejtohen këshilltarëve juridik të PPDNJ-së duke kërkuar ndihmë dhe këshilla juridike, megjithatë të njëjtën frikohen të iniciojnë procedurë kundër PAZ të MPB.

#### Rekomandime:

- Zbatimi i fushatës intensive në medime me qëllim të njohjes së qytetarëve me shërbim që u ofron projekti të quajturave viktima të sjelljes jo të drejtë të policisë.



## 3

## Struktura etnike, e moshës dhe gjinore e viktimave të evidentuara eventuale

Numri i përgjithshëm i viktimave të keqpërdorimit policit të evidentuar nga OJQ-ja **IZBOR** që mbulon pjesën juglindore të vendit arin në 13 dhe të gjitha ato janë maqedonas dhe madhor. 12 janë meshkuj dhe 1 femër.

**QZHD** evidentoi 21 viktimë të sjelljes jo të drejtë të policisë. Të gjitha ato janë madhorë dhe meshkuj. 19 janë shqiptarë, kurse 2 maqedonas.

Oficerët e projektit të **Koalicionit** kanë identifikuar 41 të quajtura viktimë të keqpërdorimit policor. Prej tyre 36 janë meshkuj kurse 5 janë femra. 39 janë madhor dhe një i mitur. 19 janë maqedonas, 14 janë shqiptarë, 3 romë, 1 turk, 1 vllah, 1 shtetas i huaj dhe 2 me përkatësi të panjohur etnike.

Rastet e regjistruara nga QZHD kanë të bëjnë me 7 të quajtura viktimë, 6 prej të cilëve janë maqedonas kurse 1 i përket nacionalitetit shqiptar. Të gjithë janë madhor kurse 1 prej të quajturave viktimë të regjistruara i përket gjinisë femërore. 6 të tjerë janë meshkuj.

**ARKA** ka evidentuar 40 të quajtura viktimë. 15 prej tyre janë rom, 13 shqiptarë dhe 12 maqedonas. 38 janë madhor kurse të tjerët të mitur. Të gjithë të quajturat viktimë të regjistruara janë të gjinisë mashkullore

**Tabela 2: Struktura etnike, e moshës dhe gjinore e të quajturave viktimë**

OJQ	Shqiptarë	Maqedonas	Romë	Meshkuj	Femra	Madhor	Të mitur	Gjithsej
<b>ARKA</b>	13	12	15	40		38	2	40
<b>Koalicioni</b>	14	19	3	36	5	40	1	41
<b>QZHD</b>	19	2		21		21		21
<b>IZBOR</b>		13		12	1	13		13
<b>QIQ</b>	1	6		6	1	7		7
<b>Gjithsej</b>	<b>47</b>	<b>52</b>	<b>18</b>	<b>115</b>	<b>7</b>	<b>119</b>	<b>3</b>	<b>122</b>

Në nivel të tërë shtetit janë *evidentuar 122 të quajtura viktimë të dhunës policore*, që paraqet rritje të numrit të të quajturave viktimë për 141,8% krahasuar me vitin 2004. 47 prej tyre janë shqiptar, 52 maqedonas, 18 romë dhe 5 të tjerë. Shprehur në përqindje, 42,62% të të quajturave viktimë janë maqedonas etnik, 38,52% janë shqiptarë etnik, 14,75% janë romë.


Pjesa më e madhe e të quajturave viktimë vijnë nga rajoni i Shkupit të cilin e mbulon Koalicioni – 33,6%, vijon pastaj rajoni i Maqedonisë verilindore të cilën e mbulon ARKA me

32,79%, pastaj QZHD që mbulon rajonin e Pollogut dhe Kërçovës me 17,21% të viktimave, OJQ-IZBOR që mbulon rajonin juglindor me 10,65% dhe QIQ me 5,74% të të quajturave viktimë. 3 nga viktimat janë të mitur, respektivisht 2,45%, femra janë 5,73%, përkatësisht 7 persona.

### Konkluzione:

- Numri i përgjithshëm i të quajturave viktimë të regjistruara të tejkalimit të autorizimeve të policisë në kuadër të PPDNJ arin 122 që paraqet rritje për 141,8% në krahasim me vitin 2004;
- Pjesa më e madhe e rasteve të evidentuara të keqpërdorimit policor vjen nga rajoni i Shkupit, nga rajoni i Kumanovës-Kriva Pallankës, si dhe nga rajoni i Strumicës;
- Pjesa dërmuese e viktimave të evidentuara të keqpërdorimit policor janë meshkuj (95,08% të të quajturave viktimë), persona madhor (94,27% të të quajturave viktimë).
- Prej 122 të quajturave viktimë të regjistruara 52 janë maqedonas, 47 janë shqiptarë dhe 18 janë rom. Shprehur në përqindje, 42,62% të të quajturave viktimë janë maqedonas etnik, 38,52% janë shqiptarë etnik, 14,75% janë rom.

**Struktura etnike e viktimave eventuale**



## 4

### *Lloji i personave të autorizuar zyrtar të involvuar në rastet e regjistruara në PPDNJ*

Sa u përket personave zyrtar të autorizuar të përzier në rastet e tejkalimit të autorizimeve të policisë, të evidentuar nga OP të Koalicionit, është shënuar me sa vijon:

Në pesë raste të tejkalimit të autorizimeve të policisë, i quajturi keqtrajtim ka ndodhur në stacionin policor Bit Pazar. Në këto raste kanë qenë të përzier personat e autorizuar zyrtar të uniformuar, kurse njëri prej keqtrajtimit të paraqitura e ka kryer *komanduesi* i stacioni policor. Është vërejtur se në katër raste të evidentuara i quajturi keqtrajtim ka ndodhur në stacionin policor “Qendër” (BEKO) me ç’rast kanë qenë të përzier persona zyrtar të autorizuar të uniformuar. Në stacionet policore “Auto Komanda” dhe “Karposh” përveç personave të autorizuar zyrtar të uniformuar, gjithashtu kanë qenë të përzier edhe inspektorë të MPB. Një viktimë ankohet se është rrahur nga policë të uniformuar nga SP Butel kurse një e quajtur viktimë ankesën e adreson në PAZ dhe te një inspektor në SPB Draçevo.

Ka pasur edhe incidente që kanë ndodhur jashtë stacioneve policore dhe i kanë kryer persona të autorizuar zyrtar/polic të uniformuar p.sh: dy prej të quajturave viktima ankohen për sjelljen jo të drejtë të personave të autorizuar zyrtar, pjesëtarë të policisë kufitare. Ankesat konkrete kanë të bëjnë me pjesëtarët e policisë kufitare në vendkalimet Tabanovcë, Bogorodicë dhe Deve Bair. Në një rast tjetër të evidentuar, personat zyrtar të autorizuar kanë qenë të përzier në bastisje eventuale jo ligjore që ka ndodhur në një punkt policor në rrugën rajonale që lidh fshatin Dollani me Shtipin. Në këtë rast të quajturat viktima kanë qenë të sulmuar nga PAZ e MPB të cilët në atë çast nuk kanë qenë në detyrë, përkatësisht kanë qenë me veshje civile.

Në 7 prej rasteve ekziston përzierje e njësive speciale policore, përkatësisht policëve të maskuar gjatë bastisjes eventuale ligjore të lokaleve, përkatësisht bastisje eventuale ligjore gjatë konfliktit, në punkt policor. Katër prej rasteve kanë të bëjnë me rrahjen eventuale brutale nga forcat policore speciale “ALFA”. Një prej të quajturave viktima ankohet për rrahje brutale në qendër të Shkupit nga forcat speciale policore “ALFA” si pasojë e së cilës viktima ka kaluar një javë në spital.


Rastet e evidentuara në rajonin që mbulon **ÀRKA** dëshmon me sa vijon:

Në shtatë raste të ARKA-s është involvuar ish komandimi i stacionit policor Rankovce. Në njërin prej rasteve është i përzier një polic nga stacioni policor “Rankovce” kurse në një rast tjetër është involvuar PAZ i MPB Shtip

Në 11 raste të evidentuara të tejkalimit të autorizimeve nga policia janë involvuar persona zyrtar të autorizuar të reformuar, të punësuar në Sektorin e punëve të brendshme në Kumanovë si dhe dy raste të përzierjes së personit të autorizuar zyrtar, të punësuar në Sektorin e punëve të brendshme në Kriva Pallankë. Në rastin theksuar të të quajturës bastisje joligjore (rasti Sopot) kanë qenë të përzier inspektorë të punësuar në Sektorin e punëve të brendshme në Kumanovë dhe përfaqësues të Shërbimeve të spiunimit. Në pesë raste kanë qenë të përzier inspektorë të Sektorin të punëve të brendshme (SPB) Kumanovë.

Në dy raste të regjistruara nga ARKA janë involvuar pjesëtarë të njësisë speciale për intervenime të shpejta “ALFA” të MPB – Shkup.

Rastet e evidentuara në rajonin e Tetovës nga QZHD kanë të bëjnë me policë të uniformuar, përkatësisht me persona të autorizuar zyrtar të punësuar në Sektorin e punëve të brendshme në Tetovë. Në njërin prej rasteve vihet në pah përzierja e ish kryeshefit të Drejtorisë së Sigurimit dhe Kundërzbulimit nga Tetova. Në dy raste ka pasur përzierje të policëve të maskuar. Dy raste kanë të bëjnë me inspektorë të SPB Tetovë kurse një prej kryerësve eventual, PAZ të SP Grupçin, OJO Tetovë e ndjek për vepër penale torturë – neni 142 paragrafi 1 nga KP



OP i IZBOR-it ka regjistruar gjashtë raste në të cilat janë involvuar PAZ të sektorit për tregti të palejuar në SPB Strumicë, në tre raste ekziston involvimi i inspektorëve të SPB Strumicë. Ekziston përzierje e personave të autorizuar zyrtar të uniformuar, në një rast – i punësuar në SPB Strumicë dhe në dy raste PAZ të punësuar në SPB Strumicë Vinicë.

Në rastin që është transferuar në QIQ nga QZHD janë involvuar PAZ persona të stacionit policor të Ohrit. Në tre raste të regjistruara nga QIQ janë involvuar inspektorë të SPB Prilep, në një rast është involvuar inspektor i SPB Kavadar. Në një rast është i përzier udhëheqësi i sektorit të krimit në SPB Prilep.

## **Konkluzione**

- Pjesa dërmuese e rasteve kanë të bëjnë me përzierjen e policëve të uniformuar në rastet e evidentuara të tejkalimit të autorizimeve të policisë;
- Në rajonin e Tetovës dhe Kumanovës rastet e tejkalimit të autorizimeve të policisë dhe veprim të keq, çojnë drejt përzierjes së policëve të uniformuar të cilët punojnë në Sektorin e punëve të brendshme (SPB) Tetovë dhe SPB Kumanovë;
- Në rajonin e Strumicës pjesa dërmuese e rasteve kanë të bëjnë me tejkalime të mundshme nga përfaqësues të Sektorit për tregti të palejuar të SPB Strumicë.
- Rastet e evidentuara të keqpërdorimit policor tregojnë përzierjen e inspektorëve të MPB në numër të konsiderueshëm rastesh;
- Në shtatë raste të ARKA-s është konstatuar përzierje eventuale e një personi-komandimi i mëparshëm i stacionit policor “Rankovce”
- Janë evidentuar raste të përzierjes së forcave speciale policore, si dhe përfaqësues të shërbimeve të zbulimit
- Në suaza të PPDNJ janë regjistruar gjashtë raste të cilat kanë të bëjnë me forcat speciale policore ALFA. Pesë nga të quajturat viktime ankohen në rrahje brutale nga ALFA-t.
- Një nga kryerësit eventuale, PAZ i SP Grupçin, OJO Tetovë e ndjek për vepër penale torturë neni 142 paragrafi 1 nga KP;
- Gjatë vitit 2005, për herë të parë nga PPDNJ janë identifikuar raste në të cilat janë përzier përfaqësues të policisë kufitare në kalimet kufitare “Deve Bair”, “Tabanovcë” dhe “Bogorodicë”;



# 5

## *Paraqitja e parashtrësive në SKBSP të MPB*

### 5.1. Hyrje

Njëri prej mekanizmave që iu mundësohet qytetarëve të cilët ankohen për sjellje jo në rregull të personave zyrtar të autorizuar të MPB, është paraqitja e parashtrësive në Sektorin e kontrollit të brendshëm dhe të standardeve profesionale të MPB. **Rregullorja për kryerjen e punëve të Sektorit** e rregullon mënyrën e paraqitjes së parashtrësive në Sektor, hetimet që i ndërmerret Sektorin e MPB në bazë të parashtrësive të paraqitura, si dhe periudhën kohore gjatë të cilës Sektorin e informon paraqitësin e parashtrësës për rezultatet e hetimit të bërë.

SKBSP merr pjesë në zbulimin e drejtpërdrejtë të parregullsive gjatë punës pasi i pranon paraqitjet anonime, parashtrësat nga qytetarët dhe të punësuarit në MPB, pas kontrollimeve dhe përgjigjeve rreth kërkesave të dorëzuara në Prokurorinë publike ose te Avokati i popullit, që kanë të bëjnë me sjellje të ndërmarrë nga persona të punësuar në MPB si dhe me punën në bazë të njohurive për veprime të kryera joligjore nga pjesëtarë të MPB, të marra përmes rrugës operative.

### 5.2. Paraqitja e parashtrësive në SKBSP

E drejta e çdo qytetari që tu paraqesë parashtrësë organeve shtetërore dhe organeve të tjera publike si dhe të marrë përgjigje lidhur me to, është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë (neni 24, paragrafi 1 të Kushtetutës së R.M.).

Neni 10 paragrafi 1 i Rregullores për kryerjen e punëve të SKBSP-së përshkruan që parashtrësat e qytetarëve të cilat kanë të bëjnë me sjelljen joligjore dhe profesionale të të punësuarve në MPB, mund të paraqiten *në formë gojore dhe të shkruar*. Gjatë paraqitjes gojore të parashtrësës qytetari i drejtohet policit kujdestar dhe ai, nëse në atë stacion nuk ka inspektor të detashuar të SKBSP-së, cakton njërin prej policëve i cili do të përpilojë **procesverbalin**. Procesverbali plotësohet në lokal të veçantë dhe menjëherë ose në afat prej një dite i dorëzohet SKBSP-së. Procesverbali nënshkruhet nga polici i cili e pranon parashtrësën nga qytetari.

Paragrafi 3 nga i njëjti nen përshkruan se në njësitë organizative territoriale të MPB në të cilat janë detashuar inspektorë të Sektorit, parashtrësat e shkruara u dorëzohen këtyre personave. Inspektorë të detashuar të Sektorit ka në këta qytete: Gostivar, Tetovë, Veles, Kumanovë, Ohër, Shtip, Strumicë, Manastir dhe në Shkup. Prania e inspektorëve të detashuar në takimet lokale koordinatave vë në dukje faktin se O.P të PPDNJ-së kanë vendosur nivel të kënaqshëm bashkëpunimi me Sektorin.

Neni 17, paragrafi 2 përcakton *periudhën kohore* në të cilën Sektori duhet patjetër ta përfundojë hetimin përkitazi me parashtrësat e paraqitura. Hetimet për format më të lehta të veprimeve joligjore dhe joprofesionale duhet të përfundojnë në afat prej **30 ditësh** nga paraqitja e parashtrësës kurse për format më të rënda të veprimit joligjor dhe joprofessional, në afat prej **90 ditësh**.

Më tutje në paragrafin 3 thuhet se pas marrjes së pëlqimit nga udhëheqësi i Sektorit dhe nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme hetimi mund të zgjasë edhe më shumë por jo më gjatë se 6 muaj. Paragrafi 4 bën plotësim ashtu që në çdo rast kur hetimi zgjat më shumë se 30 ditë, pala do të informohet në afat prej 30 ditësh nga paraqitja e parashtrësës se hetimi vazhdon për shkak të verifikimit të fakteve plotësuese.

Neni 24 i Kodit konfirmon se *Sektori është i obliguar ti njoftojë me shkrim paraqitësit e parashtrësave për ecurinë dhe rezultatin e procedurës*.

Me propozimligjin e policisë që në nëntor të vitit 2005 është në procedurë të miratimit parashihet afat prej 30ditësh nga dita e ngjarjes në të cilin qytetari mund të paraqesë parashtrësë në polici. OJQ-të që implementojnë PPDNJ janë të mendimit se afati prej 30 ditësh që propozohet është restriktiv për të drejtat e njeriut. Arsyet për këtë qëndrim mund të grupohen në këtë mënyrë:

- Nga implementimi i deritashëm i projektit mund të vërehet se në një numër të konsiderueshëm të rasteve qytetarët paraqesin parashtrësë pas afatit prej 30 ditësh, veçanërisht në rastet kur qytetarët ankohen për mosveprim të policisë. Del përfundimi se në të ardhshmen, nëse ky afat miratohet, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve nuk do të mund ti realizojnë të drejtat e tyre përmes paraqitjes së parashtrësave në SKBSP;
- Afati në të cilin mund të paraqitet parashtrësë te zyra e Avokatit të popullit është një vjet. Nga ana tjetër afati për paraqitjen e padisë private është 3 muaj. Duke krahasuar këta afate me afatin prej 30 ditësh që është në propozim, del se MPB me tekstin e propozuar dëshiron ta shkarkojë Sektorin nga një pjesë e parashtrësave, në llogari të kufizimit të të drejtave të njeriut.

OJQ-të që implementojnë PPDNJ në takim me MINOP<sup>2</sup> më 08.11.2005 paraqitën vërejtjet e tyre në lidhje me propozimligjin për policinë. Në mesin e vërejtjeve vëmendje qendrore iu dha afatit prej 30 ditëve që propozohet<sup>3</sup>. Mbetet të shikojmë vallë Grupi punues që punon tekstin e ligjit do ti pranojë vërejtjet e PPDNJ. Për fat të keq reagimet e para janë negative dhe ka një probabilitet se ligji do të miratohet Pa i marrë parasysh vërejtjet e sektorit joqeveritar në lidhje me afatin e propozuar

---

<sup>2)</sup> MINOP është grup joformal ku anëtarësojnë përfaqësues të MPB, Avokati i popullit dhe OJQ-të. OJQ-të që e implementojnë projektin në takimet e MINOP-it prezantohen nga koordinatori i projektit.

<sup>3)</sup> Afati prej 30 ditësh propozohet me nenin 8, paragrafi 1 i tekstit të Ligjit të propozuar për policinë.



### 5.3. Statusi i parashtresave të paraqitura në SKBSP nga OJQ-të të cilat implementojnë PPDNJ

Në pjesën dërmuese të rasteve të evidentuara në suaza të PPDNJ është paraqitur parashtresë në SKBSP. Tabela e mëposhtme e tregon numrin e parashtresave si dhe kërkesat për njoftim, të dorëzuara në Sektorin e MPB.

**Tabela 3: Parashtresa të paraqitura në Sektorin e MPB**

OJQ	Parashtresa të paraqitura	Njoftime të pranuar	Kërkesa për njoftim	Njoftim në bazë të kërkesës për njoftim
<b>ARKA</b>	<b>22</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>10</b>
<b>Koalicioni</b>	<b>20</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>3</b>
<b>QZHD</b>	<b>13</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>4</b>
<b>IZBOR</b>	<b>12</b>	<b>8</b>		
<b>CGI</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	
<b>GJITHSEJ</b>	<b>71</b>	<b>30</b>	<b>20</b>	<b>17</b>


Në implementimin e deritashëm të PPDNJ nga O.P. të OJQ-ve janë paraqitur parashtresa në Sektor, në 71 raste. *Përgjigje nga ana e SKBSP është pranuar në 47 raste respektivisht 66,2% të parashtresave të paraqitura.*

Afati në të cilin SKBSP përgjigjet në parashtresat e paraqitura për sjellje jo në rregull të policisë aspak nuk është në përputhje me afatet e parapara me Ligj në të cilat Sektori duhet ta zbatojë hetimin sipas gjetjeve në parashtresën e paraqitur. Edhe pse sipas nenit 17 paragrafi 2 nga Rregullorja e Sektorit, hetimet për forma më të lehta të veprimit joligjor dhe joprofesional duhet të përfundojnë në afat prej 30 ditëve nga paraqitja e parashtresës, kurse për forma më të rënda të veprimit joligjor dhe joprofesional, më së voni në afat prej 90 ditëve. Deri tani vetëm në dy raste është dhënë përgjigje parashtresës në afat prej 30 ditëve kurse në afatin prej 90 ditëve është dhënë përgjigje në 8 parashtresa.

Ndonëse vetëm për shkaqe të arsyeshme dhe në pajtim me udhëheqësin e Sektorit, hetimi mund të zgjasë më së tepërmi 6 muaj, mund të vërehet se në 28 parashtresa është dhënë përgjigje në afat prej 6 muajsh. Si mosrespektim flagrant i afatit për përgjigje të parashtresave mund të shënohet fakti se në 8 raste është dhënë përgjigje pas kalimit të periudhës prej 6 muajsh. Si kuriozitet mund të përmendet se në 2 raste është pritur përgjigje nga Sektori 10 respektivisht 11 muaj.

përmendet se në 2 raste është pritur përgjigje nga Sektori 10 respektivisht 11 muaj.

#### Afat në të cilin është dhënë përgjigje për parashtrësën e paraqitur




#### 5.4. Kërkesa për njoftim në Sektorin e MPB

Si rezultat i përgjigjeve të vonuara nga ana e përfaqësuesve të SKBSP personeli që duhet të punojë në implementimin e projektit e vendosi praktikën e parashtrimit të kërkesave për njoftim në SKBSP për rastet që nuk është dhënë përgjigje parashtrësës në afatin e duhur kohor. Në kërkesat e parashtruara për njoftim O.P. kërkojnë informata për statusin e parashtrësës së paraqitur, rezultatin e hetimit në rast se është zbatuar dhe informata për rezultatin e veprimit disiplinor, respektivisht procedurën për ndërprerje të marrëdhënies në punë të PAZ të MPB, nëse ai ka filluar dhe është zbatuar.

Pas vendosjes së praktikës për mbajtjen e takimeve lokale koordinuese, kërkesat për njoftim, përveç formës së shkruar zyrtare, u dorëzohen edhe gojarisht inspektorëve të pranishëm të Sektorit me çka bëhen përpjekjet maksimale të OJQ-ve që implementojnë projektin për shpejtimin e intervalit kohor në të cilin veprohet lidhur me parashtrësën e paraqitura.

#### 5.5. Parashtrësja të cilave SKBSP ende nuk u është përgjigjur

Sektorin nuk ka dhënë përgjigje në gjithsej 24 parashtrësja të paraqitura. 7 nga këto parashtrësja janë paraqitur në tetor 2005<sup>3</sup>, nëntë nga parashtrësja e paraqitura para më shumë se 30 e më pak se 90 ditë, 3 parashtrësja janë paraqitur para më tepër se 90 ditë kurse më pak se gjashtë kurse 5 parashtrësja për të cilat ende nuk ka përgjigje nga Sektori, janë parashtruar para më se 6 muajsh. Mund të nxirret përfundimi se veprimi i SKBSP në lidhje me parashtrësja të paraqitura në afatet e parapara me rregulloren për kryerjen e punëve të Sektorit është pikë e dobët e punës së saj.

**Parashtrësia të cilave nuk u janë përgjigjur**

*Problemi me vazhdimin e afatit në të cilin bëhet hetimi për konstatimet në parashtrësit e paraqitura dhe dërgimi i përgjigjes me shkrim parashtruesit, u potencua edhe nga zëvendës udhëheqësi i Sektorit për kontroll të brendshme dhe standarde profesionale, që ishte njëri nga prezantuesit e trajnimit për këshilltar juridik të kyçur në PPDNJ.*

Sipas të dhënave me të cilat disponon PPDNJ problemi themelor është mungesa e resurseve njerëzore që do të kishin punuar në këtë problematikë. Në të vërtetë, në disa vite të fundit është shumëfishuar numri i parashtrësive të paraqitura në Sektor, kurse numri i të punësuarve ka mbetur i njëjtë. Shtrohet pyetja, pse në kushte të punësimit të tepërt në sektorin publik të Republikës së Maqedonisë nuk bëhet riorganizim i kuadrit në atë sektor të MPB-së, në mënyrë që do ti kryente obligimet e veta në afatet e parapara me Ligj.

## 5.6. Rezultati i parashtrësive të paraqitura në SKBSP

### A) Korniza ligjore

Sipas nenit 21 paragrafi 1 i Rregullores së Sektorit, nëse gjatë hetimit konstatohet se ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për fillimin e procedurës për ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të shkeljes së disiplinës së punës, Sektori paraqet propozim për vazhdimin e hetimit te Komisioni për dorëheqje.

Sipas nenit 133 nga Marrëveshja kolektive e MPB-së Komisioni pas diskutimit të zhvilluar dhe dëshmive të prezantuara, konstaton përgjegjësinë e punëtorit dhe përgatit propozim me shkrim për Ministrin e punëve të brendshme për marrje të vendimit adekuat. Nëse Komisioni konstaton se punëtori nuk është i përgjegjshëm ose nuk janë plotësuar kushtet për marrjen e vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës me dorëheqje, i propozon ministrit ta refuzojë propozimin, respektivisht ta ndërpresë procedurën. Nëse ministri nuk pajtohet me propozimin, lëndën mund ta kthejë në rishqyrtim në raste kur gjendja faktike është konstatuar në mënyrë jo të rregullt ose jo në tërësi, gabimisht është zbatuar rregulla materiale ose mund të marrë vendim tjetër.

Varësisht nga shkalla e përgjegjësisë së punëtorit, kushtet nën të cilat është bërë shkelja e detyrave të punës, punës së mëparshme dhe sjelljes së punëtorit, peshës së lëndimit dhe pasojat e tij, Ministri mund ta ndryshojë dorëheqjen e punëtorit me dënim me të holla, i cili nuk mund të jetë mbi 15 % e rrogës mujore të punëtorit në kohëzgjatje prej 1 deri në 6 muaj.

Përveç kësaj, sipas nenit 144 paragrafi 11 i Ligjit për procedurë penale, MPB në bazë të dëshmimeve të mbledhura dhe të dhënave, kundër personit për të cilin ekziston dyshim me bazë, i cili ka kryer veprim që paraqet vepër penale, përgatit denoncim penal që së bashku me dëshmitë dhe aktet për masat dhe veprimet e ndërmarra, e dorëzon te Prokurori publik kompetent. Më tutje, sipas nenit 3 të Rregullores së Sektorit, udhëheqësi i Sektorit do ta informojë ministrin kur me hetimin e zbatuar do të konstatohet ekzistimi i veprimeve të inkriminuara, shkelje të disiplinës së punës ose sjellje joprofesionale i ndonjë të punësuarit në MPB.

### **B) Rezultati nga parashtrësit e rasteve në suazat e PPDNJ**

Në implementimin e deritashëm të projektit është marrë përgjigje në gjithsej 47 parashtrës të paraqitura dhe kërkesa për njoftim. Për 37 parashtrës të paraqitura dhe kërkesa për njoftim është dhënë përgjigje se **konstatimet në parashtrësë janë të pabaza, respektivisht se personat e autorizuar zyrtarë kanë vepruar sipas ligjit**. Kjo do të thotë se në 78,73% të rasteve ku Sektori ka përfunduar hetimin, po ai konstaton se nuk ka raste të tejkalimit të autorizimeve nga policia.

Në 10 rastet tjera të evidentuara nga O.P. të ARKA-s, të Koalicionit dhe të QZHD-së është vërejtur me sa vijon:

Në rastin **KU001** të evidentuar nga O.P. i ARKA-s është zbatuar *procedurë disiplinore* dhe kryerësit janë dënuar me gjobë në lartësi prej 15% të shumës së rrogave të tyre në kohëzgjatje prej 6 muaj. Në rastin **KU009** është marrë njoftim në të cilin thuhet se pohimet e theksuara në ankesë janë të bazuara përkatësisht personi i autorizuar zyrtar nuk ka vepruar në përputhje me rregullat dhe dispozitat e MPB. Do të jepet rekomandim për ngritjen e procedurës disiplinore kundër personit të autorizuar zyrtar në përputhje me Marrëveshjen kolektive të MPB. Sidoqoftë, ende nuk ka informata për rezultatin e procedurës disiplinore, poqë se e njëjta është zbatuar. O.P. të ARKA-s dy herë i drejtohen Sektorit me kërkesë për informata lidhur me rezultatin e procedurës disiplinore por nga Sektori nuk ka kurrfarë përgjigje. Persona të autorizuar zyrtar të MPB në Kriva Pallankë kanë dorëzuar fletëparaqitje për kundërvajtje kundër të quajturës viktimë, në bazë të nenit 12 të Ligjit për kundërvajtje.

Në lidhje me rastin **KU017** nga Sektori është marrë përgjigje personi i autorizuar zyrtar nuk ka vepruar në pajtim me rregullat dhe dispozitat e MPB. Eprori i autorizuar do të ndër marrë masa adekuate kundër personit të autorizuar zyrtar, në përputhje me Marrëveshjen kolektive të MPB. Megjithatë, edhe pas bërjes së dy kërkesave nga O.P. të ARKA-s për informata lidhur me rezultatin e procedurës nuk ekziston kurrfarë informate lidhur me masat e ndërmarra kundër personit të autorizuar zyrtar. Vlen të përmendet se

kundër të quajturës viktimë është dorëzuar fletëparaqitje për kundërvajtje për kryerje të kundërvajtjes në bazë të nenit 15 paragrafi 1, pika 3 të Ligjit për kundërvajtje. Në të gjitha rastet tjera për të cilat ARKA ka marrë përgjigje SKBSP-ja nuk ka gjetur se PAZ-i i MPB-së ka bërë shkelje të të drejtave dhe lirive të të quajturëve viktimë.

Sa i përket rajonit të Maqedonisë Perëndimore të mbuluar nga QZHD-ja mund të prezantohen këta raste:

Për rastin **TE001** është marrë njoftim nga Sektori se ata kanë vepruar lidhur me parashtrësën e të quajturës viktimë dhe i kanë analizuar pohimet. Sektori i punëve të brendshme nga Tetova ka bërë denoncim penal kundër kryeshefit të Drejtorisë së sigurisë dhe kundërzbulimit në Tetovë për veprë penale keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit, neni 353, paragrafi 1 nga Kodi Penal. Në njoftim më tutje thuhet se të gjitha veprimet e mëtejshme janë në kompetencë të PPTH-së dhe të Gjykatës themelore të Tetovës dhe se Sektori nuk mund të përzihet në punën e tyre. Sa i përket rastit **TE002** SKBSP ka dërguar njoftim në të cilin thuhet se Sektori vepron rreth parashtrësës së pranuar dhe kërkesës për njoftim me qëllim që ti hetojë pohimet dhe se e quajtura viktimë do të njoftohet në kohë për rezultatin e hetimit. Sektori, gjithashtu, ka kërkuar mirëkuptim nga të quajturat viktimë, për vazhdimin e hetimit për faktin se është fjala për “rast të vjetër”. Ende është duke u pritur që të jepet përgjigje “në kohë”.

*Në përgjigjen e Sektorit lidhur me rastin **TE003** thuhet se Sektori në tërësi e ka hetuar parashtrësën e të quajturës viktimë dhe se në bazë të hetimit të bërë nuk ka mundur të verifikohet se cilat forca policore e kanë kryer bastisjen dhe e kanë keqtrajtuar të quajturën viktimë. Më tutje të quajturës viktimë i këshillohet që të ngrejë padi private kundër kryerësve të panjohur, në gjykatën kompetente. Lidhur me rastin **TE012** SKBSP dërgoi njoftim në të cilin thuhet se Sektori do të veprojë sipas vendimit gjyqësor, përkitazi me sendet e marra gjatë konfliktit në vitin 2001. Procedura gjyqësore është në vijim e sipër. Në **pesë raste** tjera të regjistruara nga QZHD, është marrë njoftim nga SKBSP se pas hetimit të bërë është verifikuar se nuk ka shkelje të të drejtave të të quajturëve viktimë nga ana e Policisë.*

Sa i përket rastit **SK003** O.P. të Koalicionit gojarisht i është kumtuar se është vepruar përkitazi me theksimet në parashtrësë dhe se pas hetimeve të bëra është zbatuar procedurë disiplinore, sipas së cilës kryerësit janë dënuar me 15% të rrogës. Nuk është kumtuar as sa muaj do të zgjasë masa disiplinore. Përgjigje me shkrim nuk është marrë. Bile edhe përgjigja e këtitillë e varfër është marrë pas dy kërkesave për njoftim dhe pas takimit me zëvendës udhëheqësin e Sektorit të MPB me ç’rast janë kërkuar informata lidhur me rastin në fjalë. Sa i përket rastit **SK005** SKBSP ka dërguar përgjigje në të cilin thuhet se pohimet e dorëzuesit të parashtrësës janë pjesërisht me bazë dhe të sakta dhe Sektori e udhëzoi të quajturën viktimë të bëjë padi private kundër personit të autorizuar zyrtar të përzier në këtë rast. Në njoftimin e pranuar nuk përmendet aspak se a është duke u bërë hetim e as për rezultatin e procedurës. Kundër personit të autorizuar zyrtar në këtë rast nuk janë shqiptuar kurrfarë masash ose sanksionesh administrative. Vërehet se në rastin **SK006** është marrë njoftim nga Sektori në të cilin thuhet se kundër dy personave të autorizuar zyrtar Sektori ka përgatitur *propozim me mendim për marrjen e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje* të paraqitur te komisioni për dorëheqje, për shkak të faktit që personat e autorizuar zyrtar në SPB Shkup nuk kanë vepruar në

përputhje me Marrëveshjen kolektive të MPB-së, Dispozitën për përdorimin e armës së zjarrtë dhe rregulloren për kryerjen e punëve në MPB. Edhe në këtë rast O.P. nga rajoni i Shkupit janë njoftuar gojarisht se të dy PAZ të përzier në këtë rast u është shqiptuar dënime me gjobë në lartësi prej 15% të rrogës.

Në të gjitha rastet tjera në të cilat O.P. të **Koalicionit** kanë marrë përgjigje SKBSP-ja nuk ka gjetur shkelje të të drejtave dhe lirive të të quajturave viktime nga PAZ të MPB-së.

OJQ **IZBOR** ka marrë përgjigje për tetë nga parashtresat e paraqitura dhe në asnjë nga këto raste SKBSP pas hetimit të zbatuar nuk ka gjetur shkelje të të drejtave dhe lirive të të quajturave viktime nga PAZ të MPB.


Si **rezyme** nga 10 rastet e përmendura në të cilat është marrë përgjigje nga Sektori për parashtresat e paraqitura në të cilat është konstatuar shkelje e të drejtave të të quajturave viktime, mund të shënohet me sa vijon:

- Në tre nga rastet e evidentuara të sjelljes jo në rregull të policisë, kryerësve u është shqiptuar sanksion administrativ në lartësi prej 15% të rrogës. Në njërin nga ato raste sanksioni administrativ është në kohëzgjatje prej 6 muajsh, kurse në dy rastet tjera nuk dihet për sa muaj është caktuar sanksioni administrativ.
- Në një rast Sektori për punë të brendshme nga Tetova ka paraqitur denoncim penal kundër të quajturit kryerës, kurse rasti gjendet në Gjykatën themelore Tetovë.
- Në dy raste nga rajoni i Kumanovës është pranuar njoftim se ka filluar procedura disiplinore kurse përgjigje për atë se a janë caktuar dhe çfarë sanksionesh janë shqiptuar nuk ka as pas dy kërkesave për njoftim në çdonjërin nga këto dy raste.

Në këto raste stagon transparenca në punën e Sektorit. Në njoftimin e Sektorit për njërin nga rastet thuhet se hetimi është zgjatur sepse rasti ka qenë i vjetër, kurse në një tjetër rast Sektori ka njoftuar se nuk ka qenë e mundur të konstatohet cilat forca policore kanë bërë bastisjen dhe kanë keqtrajtuar të quajturën viktimë. Në rastin e 9 është pranuar njoftim se theksimet janë pjesërisht të sakta dhe e quajtura viktimë është udhëzuar që të paraqesë padi private. Sanksione disiplinore kundër kryerësit nuk janë marrë. Në rastin e 10 SKBSP ka dërguar njoftim në të cilin thuhet se Sektori do të veprojë sipas vendimit gjyqësor në lidhje me gjësendet e marra gjatë konfliktit në vitin 2001. Procedura gjyqësore është në vijim e sipër.



## Rezultati i parashtrësave të përgjigjura



Duhet theksuar se në disa nga rastet e të quajturit keqpërdorim policor, Policia ka paraqitur denoncime penale dhe për kundërvajtje kundër të quajturave viktime.

### 5.7. Si dënohen PAZ të MPB që shkelin të drejtat e njeriut

Nga rastet e evidentuara, të prezantuara deri tani në kuadër të PPDNJ, mund të vërehet se **sanksioni i vetëm<sup>4</sup> që u është shqiptuar personave të autorizuar zyrtarë të MPB-së** për të cilët është konstatuar se nuk kanë vepruar sipas rregullave dhe dispozitave të MPB-së, respektivisht **në rastet e evidentuara të keqpërdorimit policor, është dënim me të holla në lartësi prej 15% të rrogës.**

Në rastet e evidentuara në kuadër të PPDNJ, nuk është dhënë asnjë dorëheqje për ndonjë PAZ të MPB-së. Aq më tepër Ministri i punëve të brendshme ka të drejtë ta zëvendësojë dorëheqjen e të punësuarit me dënim me të holla i cili nuk mund të jetë mbi 15% të rrogës mujore të punëtorit në kohëzgjatje prej një deri gjashtë muaj.

Brengos fakti që paraqitësi i parashtrësës nuk njoftohet për sanksionin që i është caktuar PAZ-i, kryerës të veprës. Kjo sipas nenit 23 të rregullores për kryerje të punëve të Sektorit e cila parasheh që paraqitësi i parashtrësës të informohet se a është ndërmarrë masë disiplinore kundër kryerësit, por nuk do të njoftohet për llojin e masës.

Dispozita e lartpërmendur është në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë i cili parasheh që çdo qytetarë ka të drejtë të paraqesë parashtrësë ndaj organeve shtetërore dhe shërbimeve tjera publike dhe të marrë përgjigje për këtë. Me përgjigje nënkuptohet përgjigje e plotë, e jo përgjigje e pjeshme.

### Konkluzione:

- Parashtrësat për sjellje jo në rregull të policisë mund të paraqiten te Sektori i MPB-së dhe te inspektorët e detashuar të Sektorit në 8 qytete në Maqedoni;

<sup>4)</sup> Sanksionet tjera janë: Dorëheqje dhe largim i përkohshëm nga puna të PAZ-it

- Personeli që punon në implementimin e projektit vendosi praktikën e paraqitjes së kërkesave për njoftim në SKBSP për raste kur nuk është vepruar për ndonjë parashtrësë të caktuar në kohën e paraparë për veprim sipas parashtrësës së paraqitur;
- Dënimi i vetëm që u është shqiptuar PAZ të MPB për të cilët është konstatuar se kanë tejkalluar autorizimet e tyre me shkeljen e të drejtave të qytetarëve, paraqet sanksioni administrativ- 15% të rrogës mujore në kohëzgjatje prej 1 deri në gjashtë muaj;
- Nga gjithsej 71 parashtrësë të O.P. të OJQ-ve të cilat implementojnë PPDNj është parë përgjigje për gjithsej 47. Nga ato është konstatuar tejkallim i autorizimeve të policisë në gjithsej 9 raste.;
- Numri i të punësuarve në Sektor, të cilët veprojnë sipas parashtrësave të paraqitura, është konstant vite me radhë, edhe pse numri i parashtrësave të paraqitura në Sektor është shumëfishuar.

### Objekt i brengosjes:

- Në rast të konstatimit të tejkallimeve të autorizimeve nga ndonjë PAZ i policisë, paraqitësi i parashtrësës nuk njoftohet për atë se cili sanksion i është shqiptuar PAZ-it, kryerës i veprës. Aq më tepër bazë për këtë sjellje jo transparente të Sektorit është neni 23, paragrafi 2 pika 4. të Rregullores për kryerjen e punëve të Sektorit<sup>5</sup>. Dispozita nga Rregullorja është në kundërshtim me nenin 124 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë<sup>6</sup>;
- Në një pjesë të rasteve të regjistruara të të quajturit keqpërdorim policor, policia ka bërë denoncime penale dhe për kundërvajtje kundër të quajturave viktime.
- Me propozimligjin e policisë që në nëntor të vitit 2005 është në procedurë të miratimit parashihet afat prej 30 ditësh nga dita e ngjarjes në të cilin qytetari mund të paraqesë parashtrësë në polici. OJQ-të që implementojnë PPDNj janë të mendimit se afati prej 30 ditësh që propozohet është restriktiv për të drejtat e njeriut;
- Periudha kohore gjatë së cilës Sektori i MPB vepron lidhur me parashtrësat e paraqitura për tejkallimin e autorizimeve të Policisë ose për veprim të keq është propozim dhe nuk korrespondon me afatet e caktuara në Rregulloren e punës të Sektorit;
- Përfaqësuesit e Sektorit nuk i njoftojnë me shkrim paraqitësit e parashtrësave për rrjedhën e procedurës e as që informohen paraqitësit e parashtrësave për arsyet e kalimit të afatit prej 30 ditësh ndonëse për këtë janë të detyruar me nenin 17 paragrafi 4 dhe nenin 24 të Rregullores për kryerjen e punëve në Sektor;
- Sistemi i hetimit të ankesave lidhur me tejkallimin e autorizimeve të policisë nuk është transparent, në kohë, i plotë dhe objektiv në atë masë që është e domosdoshme për një shoqëri demokratike evropiane.

<sup>5</sup> Paraqitësi i parashtrësës do të informohet a është marrë masë disiplinore kundër kryerësit pa u përmendur lloji i masës .

<sup>6</sup> Çdo qytetarë ka të drejtë të paraqesë parashtrësë në organet shtetërore dhe në shërbimet tjera publike dhe për to të marrë përgjigje.



## **Rekomandime**

- Sektori i MPB-së duhet ti shmanget çdo zgjatjeje të panevojshme të zgjidhjes së rasteve lidhur me keqpërdorimin policor;
- MPB-ja të ndërmarrë masa me qëllim të sigurimit të hetimit të plotë, objektiv, transparent dhe në kohë nga ana e Sektorit rreth parashtresave të paraqitura lidhur me tejkalimin e autorizimeve të policisë ose sjelljes së keqe;
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë ta shqyrtojë mundësinë e vendosjes së organit të pavarur të jashtëm për shqyrtimin e parashtresave lidhur me tejkalimin e autorizimeve nga policia, në pajtim me Standardet sipas Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut;
- Riekipimi i kuadrove të Sektorit me qëllim që i njëjti të mund të veprojë rreth parashtresave të paraqitura në përputhje me afatet e parapara me Rregulloren e punës së Sektorit;
- Të quajturat viktime të informohen në kohë për rrjedhën dhe kohëzgjatjen e procedurës rreth parashtresave të paraqitura përkatësisht të punësuarit në Sektor të veprojnë në përputhje me nenin 17, paragrafi 4 dhe neni 24 të Rregullores për kryerjen e punëve të Sektorit;
- Të ngrihet iniciativë në Ministrinë e punëve të brendshme për ndryshimin e nenit 23 paragrafi 2 pika 4 të rregullores për kryerjen e punëve të Sektorit dhe për shtimin e dispozitës në nenin e përmendur me të cilën Sektori do të obligohej që viktimat e sjelljes jo të drejtë të policisë të informohen për masat e ndërmarra kundër PAZ të Policisë në evidentimin e rasteve të keqpërdorimit policor;
- Të ngrihet iniciativë në Ministrinë e punëve të brendshme dhe në Sindikatën e Policisë maqedonase për shlyerjen e nenit 138 të marrëveshjes Kolektive të MPB-së me të cilin i jepet e drejta Ministrit që dorëheqjen e të punësuarit ta zëvendësojë me dënim me të holla;



# 6

## *Paraqitja e parashtrësave në Zyrën e Avokatit të Popullit*

### **6.1. Kompetenca e Avokatit të popullit**

Sipas nenit 2 të Ligjit të Avokatit të Popullit, avokati i popullit është organ i Republikës së Maqedonisë i cili i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe të gjithë personave të tjerë kur u janë shkelur me akte, veprime dhe lejimin e veprimeve nga organet të administratës shtetërore dhe nga organe dhe organizata të tjera që kanë autorizime publike.

Si risi paraqiten 6 zyrat rajonale të avokatit të popullit<sup>7</sup> në këto qytete: Manastir, Strumicë, Shtip, Kërçovë, Kumanovë dhe Tetovë. Me këtë është lehtësuar dukshëm qasja e qytetarëve deri te ky Institucion në nivel lokal.

### **6.2. Paraqitja e parashtrësës te Avokati i popullit**

Çdo person (fizik, juridik) mund t'i paraqesë parashtrësë Avokatit të popullit, kur do të vlerësojë se i janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore. Parashtrësja paraqitet me shkrim ose me gojë në procesverbal në Zyrën e Avokatit të Popullit dhe për të vepruar rreth tyre nuk paguhen kurrfarë taksash.

Duke vepruar lidhur me parashtrësat Avokati i popullit mund të veprojë sipas njëres prej këtyre mënyrave: Të mos ngrejë procedurë, të ngrejë procedurë dhe ta ndërpresë, ose ndal procedurën. Nuk do të ngrehet procedurë nëse rreth lëndës së procedurës në vijim është duke u mbajtur procedurë gjyqësore, përpos për zgjatjen e saj të paarsyeshme ose nëse është kaluar afati prej 1 viti prej vendimit të fundit ose veprimet e organit me të cilin është bërë shkelja.

Avokati i popullit e informon paraqitësin e parashtrësës në afat prej 15 ditësh nga pranimi i parashtrësës për ngritjen e procedurës sipas konstatimeve në parashtrësë ose për mos ekzistimin e bazës për ngritjen e procedurës. Kur Avokati i popullit do të konstatojë se janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore dhe liritë e njeriut mund t'i zbatojë masat që vijojnë:

1. Të japë rekomandime, propozime, mendime dhe të vë në pah mënyrën e evitimit të shkeljeve të konstatuara;
2. Të propozojë zbatimin e sërishëm të një procedure të caktuar në përputhje me ligjin;

<sup>7</sup>) Zyrtat rajonale janë paraparë me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit.

3. Të ngrejë iniciativë për zhvillimin e procedurës disiplinore kundër personit zyrtar, përkatësisht personit përgjegjës;
4. Të iniciojë kërkesë te Prokurori Publik kompetent për të ngritur procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë ndëshkuese.

### 6.3. Statusi i parashtresave të paraqitura te Avokati i Popullit

OJQ	Parashtresa të paraqitura	Parashtresa për të cilat është dhënë përgjigje
IZBOR	10	8
QZHD	10	8
Koalicioni	18	10
ARKA	9	6
QIQ	4	1
<b>GJITHSEJ</b>	<b>51</b>	<b>33</b>

Me sa mund të vërehet nga tabela janë paraqitur gjithsej 51 parashtresa në Zyrën e Avokatit të popullit, prej tyre është marrë përgjigje për 33 parashtresa, përkatësisht 64,7% nga numri i përgjithshëm.

Lidhur me 5 ankesat e paraqitura, Zyra e Avokatit të popullit ka zbatuar nenin 20, paragrafin 7 të Ligjit të Avokatit të popullit, ku ceket se Avokati i popullit nuk do të ngrejë procedurë lidhur me parashtresën poqë se ka kaluar më shumë se një vit nga veprimi ose nga vendimi i fundit i organit ose organizatës, përveç nëse vlerëson ai se paraqitësi e ka lëshuar afatin për shkaqe të arsyeshme.

Në katërbëdhjetë raste Avokati i popullit ka vlerësuar se nuk ekzistojnë shkelje të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të paraqitësit. Në dy prej këtyre 10 rasteve, në arsyetimin e vendimit është theksuar se policia gjatë kryerjes së detyrave të veta ligjore, duhet ta respektojë dinjitetin njerëzor.

Në dy raste (SK015 dhe SK016), është marrë përgjigje nga zyra e avokatit të popullit në të cilën thuhet se avokati i popullit i ka dërguar i ka dërguar udhëzim MPB-së, sektorit të policisë kufitare – Shkup si t'i zbatojë dispozitat juridike që kanë të bëjnë me kalimin e kufirit shtetëror të Republikës së Maqedonisë. Me këtë konstatohet përfundim i procedurës. Në njërin prej rasteve (SK024) në përgjigje theksohet se bëhet fjalë për një rast jo aq të rëndësishëm dhe Avokati i popullit nuk do të ngrejë procedurë për të sipas nenit 20 paragrafi 4 nga Ligji për A.P. Nuk është vepruar rreth rasteve **TE014 dhe TE016** sepse lëndët gjenden në procedurë gjyqësore sipas nenit 20 paragrafi 8 nga Ligji për A.P.

Në një nga rastet (KU001) Zyra e Avokatit të popullit ka njoftuar të quajturën viktimë se PPTH në Kumanovë ka paraqitur akuzë kundër kryerësve të mundshëm. Në rastin SK004 Avokati i popullit ka paraqitur kërkesë te Prokurori publik kompetent për ngritjen e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë ndëshkuese.


Në rastin TE001, zyra e Avokatit të popullit i dha direktiva Sektorit të MPB-së për veprimet që duhet ndërmarrë dhe pas njoftimit të pranuar, zyra e Avokatit të popullit e ka informuar

të quajturën viktimë se institucioni e ka ndërprerë procedurën për shkak të dërgimit të denoncimit penal nga SPB në Tetovë kundër kryerësit të mundshëm. Po ashtu zyra e Avokatit të popullit është informuar nga PPTH e Tetovës se ato i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për plotësimin e denoncimit penal.

Në lidhje me rastin **KU005** të O.P. të ARKA-s u ishte dhënë dokumenti “ Mendim në lidhje me intervenimin policor në fshatin Sopot” dërguar MPB-së nga zyra e Avokatit të popullit. Në mendim theksohet se është konstatuar që MPB gjatë kryerjes së aksionit në Sopot ka shkelur të drejtat e njeriut të një pjese të banorëve të atij fshati. Gjatë kësaj ka konstatuar shkelje të nenit 7 nga Ligji i punëve të brendshme; nenet 4,5,6,50,51 dhe 52 nga Rregullorja për kryerjen e punëve të MPB-së, si dhe nenin 7 nga Dispozita për përdorimin e armëve të zjarra.

Në rastin **KU020** zyra e Avokatit të popullit ka konstatuar se PAZ të MPB-së kanë shkelur të drejtat themelore dhe liritë themelore të njeriut. Është konstatuar se është bërë shkelje e nenit 12 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe nenit 5 nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Në rastin **KU021** zyra e Avokatit të popullit ka konstatuar se PAY të MPB-së kanë shkelur të drejtat themelore dhe liritë themelore të njeriut. Kërkohet nga PAZ të MPB-së të ndërmarrin procedurë disiplinore kundër të quajturve kryerës.

Në rastin **PP003** zyra e Avokatit të popullit ka njoftuar se mendon që MPB-ja ka ndërmarre masat e nevojshme kundër të quajturit kryerës të shkeljeve prandaj A.P. më tutje nuk do të vazhdojë procedurën rreth rastit.



Vlen të theksohet fakti se zyra e Avokatit të popullit respekton afatin prej 15 ditësh nga pranimi i parashtresës në të cilën lajmërohet paraqitësi i parashtresës për atë se vallë është ngritur ose jo procedurë sipas nenit 20, paragrafi 9 dhe neni 22 nga ligji për Avokatin e popullit. Nuk është paraparë afat ligjor në të cili zyra e Avokatit të popullit duhet ta kryejë procedurën për parashtresën e paraqitur.

### **Konkluzione:**

- Me hapjen e zyrave rajonale të Avokatit të popullit në gjashtë qytete të Maqedonisë dukshëm është lehtësuar qasja e të quajturave viktime të keqpërdorimit policor dhe në përgjithësi të gjithë qytetarëve deri te ky institucion relevant, në nivel lokal;
- Në 15 nga parashtresat për të cilat është marrë përgjigje, Avokati i popullit nuk ka konstatuar shkelje të të drejtave ligjore dhe kushtetuese të qytetarëve, ndërsa në pesë raste nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprimesh sipas nenit 20 paragrafi 7 nga Ligji për Avokatin e popullit (afat i kaluar prej një viti nga shkelja e bërë). Përgjigje është marrë për 33 nga gjithsej 51 parashtresa të paraqitura;

### **Rekomandime:**

- Të ndërmerret iniciativë për ndryshime dhe plotësimet e paralajmëruara të Ligjit për Avokatin e popullit me të cilën do të inkuadrohet dispozita në tekstin ligjor, me të cilën do të parashihet afat gjatë të cilit Avokati i popullit do të jetë i obliguar të përfundojë procedurën e parashtresës së paraqitur, si dhe mekanizëm për njoftim periodik të qytetarëve për gjendjen e parashtresës së paraqitur për të cilën nuk është marrë përgjigje në afatin e paraparë ligjor.
- Shfrytëzim ekstensiv i dispozitës së nenit 25, paragrafi 2 nga Ligji për Avokatin e Popullit. Kjo dispozitë e autorizon A.P. në rastin kur është konstatuar shkelje e të drejtave dhe obligimeve ligjore, shpjegim të rastit përmes mjeteve të informimit publik me shpenzime të organit që ka bërë shkelje (në këtë rast MPB);
- Zbatim ekstensiv i nenit 30, paragrafi 1, me të cilën Avokatit të popullit i jepet autorizim të ngrejë iniciativa për ndryshime dhe plotësime të ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore te propozuesit e autorizuar, kurse në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë punën e policisë.

# 7

## *Shturje e rasteve të PPDNJ që nga ngritja e denoncimit penal e deri te ngritja e aktakuzës*

### 7.1. Korniza ligjore

Sipas nenit 42 të Ligjit për procedurë penale (LPP) obligim dhe e drejtë e përgjithshme e Prokurorit publik është ndjekja penale e kryerësve të veprave penale të cilat ndjekën *ex officio*. Poashtu, për vepra penale për të cilat bëhet ndjekje me detyrë zyrtare, prokurori publik është kompetent për ndërmarrjen e masave të nevojshme në lidhje me zbulimin e veprave penale dhe me gjetjen e kryerësve dhe për orientim të paraprocudurës penale; në paraprocudurën hetuesetë japë urdhëra për zbatimin e masave të veçanta hetuese nën kushte dhe në mënyra të caktuara me këtë ligj; të kërkojë zbatimin e hetimit, ta ngrejë dhe përfaqësojë aktakuzën, respektivisht propozim�akuzën para gjykatës kompetente; të bëjë ankesa kundër vendimeve gjyqësore jo të plotëfuqishme dhe të paraqesë mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore të plotëfuqishme.

Sipas nenit 160 nga LPP, hetimi kundër ndonjë personi të caktuar ngrihet atëherë kur ekziston dyshim i bazuar se ai /ajo kanë bërë vepër penale. Hetimi zbatohet me kërkesën e Prokurorit publik, kërkesa dërgohet te gjykatësi hetues. Pasi që gjykatësi ta pranojë kërkesën për zbatimin e hetimit ai do t'i shikojë aktet dhe po qe se pajtohet me kërkesën do të marrë vendim për zbatimin e hetimit. Vendimi për zbatimin e hetimit, po ashtu, do të dërgohet te Prokurori publik dhe te i akuzuari.

Neni 142, paragrafi 1 nga LPP stipulon se organet shtetërore, institucionet që kryejnë autorizime publike dhe persona tjerë juridikë janë të obliguar të paraqesin vepra penale për të cilat bëhet ndjekje me detyrë zyrtare, për të cilat janë njoftuar ose për të cilat kanë marrë vesh në mënyrë tjetër. *Në rastet e regjistruara të PPDNJ në 2 raste denoncim penal ka paraqitur zyra e Avokatit të popullit , kurse në një rast denoncim penal ka paraqitur SPB-ja në Tetovë.*

*Risi në Ligjin është paragrafi 3 nga neni i lartpërmendur, sipas të cilit çdonjëri është i obliguar të paraqesë vepër penale për të cilën bëhet ndjekje me detyrë zyrtare.*

Në nenin 174 paragrafi 2 i LPP është dhënë obligimi që gjykatësi hetues duhet ta informojë prokurorin publik për ekzistimin e arsyeve për ndërprerje të hetimit dhe nëse Prokurori publik nën afat prej 8 ditëve nuk njofton gjykatësin hetues se heq dorë nga ndjekja, gjykatësi hetues do të kërkojë nga Këshilli të marrë vendim për ndërprerjen e procedurës.

Gjykatësi hetues është i obliguar të ndërpresë hetimin nëse gjatë hetimit ose pas tij, Prokurori publik heq dorë nga ndjekja.

Neni 177, paragrafi 2 nga LPP parasheh afat 15 ditësh pas kryerjes së hetimit në të cilin prokurori publik është i obliguar të japë propozim për plotësimin e hetimit ose për ngritjen e aktakuzës ose të deklarojë se heq dorë nga ndjekja. Këshilli gjyqësor mund të prolongojë këtë afat me propozim të Prokurorit publik.

Me ndryshimet e LPP\_së në mars 2005 në vend të afatit prej 8 ditëve, në nenin 179 paragrafi 3 parashihet **afat 15 ditësh** në të cilin i dëmtuari si paditës ose paditësi privat mund të paraqesë aktakuzë respektivisht padi private, dhe nëse nuk e bëjnë këtë, do të llogaritet se kanë hequr dorë nga ndjekja. Me këtë ndryshim të afatit kohor përmirësohet pozita e të dëmtuarit si paditës dhe e paditësit privat në procedurën penale.

## 7.2.Razultati i Denoncimeve penale të paraqitura në Prokurorinë publike

OJQ	Është parashtruar kallëzim penal	Është parashtruar aktakuzë	PPTH heq dorë nga ndjekja e mëtejshme	Padi supsidijare është parashtruar
<b>Koalicioni</b>	<b>4</b>		<b>2</b>	<b>2</b>
<b>ARKA</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	
<b>QZHD</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>QIQ</b>	<b>1</b>			
<b>GJITHSEJ</b>	<b>22</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>3</b>

Lidhur me rastin **SK004**, Zyra e Avokatit të popullit i ka bërë kërkesë PPTH-së në Shkup për fillimin e procedurës për përcaktimin përgjegjësisë penale dhe e njëjta ka qenë e pranuar në tërësi. Procedura në zyrën e avokatit të popullit është ndërprerë dhe ka vazhduar në gjykatë si procedurë hetuese. Më 19.05.2004 dëshmitarët janë marrë në pyetje nga gjykatësi hetues. Personat zyrtar të autorizuar të MOB-së nuk janë marrë në pyetje nga gjykatësi hetues edhe pse ka ekzistuar urdhëresa për arrestim të detyrueshëm. Ndërkohë, gjykata hetuese i ka marrë në pyetje të dy personat zyrtar të autorizuar e të dyshuar, dhe pas kësaj rasti është kthyer në Prokurorinë themelore publike, Më 28.01.2005 PPTH ka marrë vendim për heqje dorë nga ndjekja penale. E quajtura viktimë në këtë rast e merr mbi vete ndjekjen në përputhje me nenin 56 të ligjit për procedurë penale. *Rasti në këtë moment gjendet në procedurë gjyqësore.*

Në rastin **SK007** e quajtura viktimë ka bërë denoncim penal në PPTH në Shkup. Prokurori publik ka bërë kërkesë drejtuar gjykatësit hetues i cili ka marrë vendim që të zhvillojë hetim. Për mungesë të dëshmive PPTH ka hequr dore nga ndjekja. Në përputhje me nenin 173 të LPP-së gjykatësi hetues ka ndërprerë hetimin për shkak të heqjes dorë të PPTH-së nga ndjekja. Pas njoftimit nga gjykatësi hetues, e quajtura viktimë ka dorëzuar propozim për vazhdimin e ndjekjes. *Rasti gjendet në procedurë gjyqësore.*

Në rastin SK011, e quajtura viktimë ka dorëzuar denoncim penale për rrëmbim në PPTH-Shkup më 07.09.2004. Për të njëjtën vepër penale, MPB-ja ka bërë denoncim penale kundër kryerësit. PPT ka dorëzuar kërkesë te gjykatësi hetues për të iniciuar hetim. Kryerësi i mundshëm nuk është paraqitur në procesin e caktuar të marrjes në pyetje nga gjykatësi



hetues. *Hetimi është kryer. Pritet në përgjigje nga PPTH lidhur me denoncimin e paraqitur.* Në rastin SK010 denoncim penal është paraqitur më 12.02.2004 por ende nuk është marrë njoftim lidhur me denoncimin e paraqitur penal. E quajtura viktimë ka vdekur.

Janë paraqitur denoncime penale në PPTH Kumanovë lidhur me rastet në vijim: **KU005** më 27.06.2003, **KU007** më 17.02.2003, **KU008** më 08.07.2004, KU më 13.06.2005, **KU024** më 21.06.05 i **KU025** më 18.07.2005. Në asnjërën prej këtyre denoncimeve të paraqitura penale nuk ka përgjigje nga PPTH Kumanovë edhe pse dy prej tyre janë paraqitur para më shumë se dy vjet.

Denoncim penal në PPTH të Kumanovës lidhur me rastet **KU021** është paraqitur më 04.04.2005, kurse për rastin KU025 është paraqitur më 12.07.2005. nga të dyja rastet PPTH në Kumanovë ka hequr dorë nga ndjekja penale. Për rastin **KU001**, denoncimi i paraqitur penal nga zyra e avokatit të popullit ka qenë e përkrahur tërësisht nga PPTH në Kumanovë dhe në përputhje me nenin 161 të LPP. PPTH ka dorëzuar kërkesë te gjykatësi hetues për zbatimin e hetimit. PPTH ka ngritur akt akuzë.

Lidhur me rastin **TE001**, SPB në Tetovë ka bërë denoncim penal më 20.04.04 në PPTH të Tetovës për vepër penale keqpërdorim i detyrës zyrtare. E quajtura viktimë ka qenë e informuar se *PPTH nga Tetova ka hequr dorë nga ndjekja penale më 24.03.2005.* E quajtura viktimë në këtë rast e ka ndërmarrë ndjekjen në pajtim me nenin 26, paragrafi 2 nga LPP. Sa i përket rastit **TE018** denoncimi penal është paraqitur në shtator 2005. PPTH në Tetovë ka përkrahur denoncimin e paraqitur penal dhe e ndjek të quajturin kryerës sipas nenit 142, paragrafi 1 të KP Torturë dhe sjellje tjetër e vrazhdë, jonjerëzore ose përçmuese ose ndëshkim. Janë paraqitur denoncime penale në PPTH Tetovë lidhur me rastet në vijim: **TE002** më 04.04.2004, **TE003** më 10.05.2004, **TE008** më 30.11.2004, **TE009** më 12.01.2005, **TE017** më 19.10.05. Në asnjërën prej denoncimeve të paraqitura në fjalë nuk ka përgjigje nga PPTH Tetovë. Në rastin **TE016** e quajtura viktimë ka paraqitur padi private kundër të kryerësve të mundshëm.

Lidhur me rastin **TE010** PPTH në Tetovë ka hequr dorë nga ndjekja penale më 21.05.2005 sepse vepra ka qenë e përfshirë me Ligjin e Amnitisë. Denoncimi penal është paraqitur më 03.02.2005.



Siç mund të vërehet në 2/3 të rasteve të PPDNJ në të cilat janë paraqitur denoncime penale në PPTH hetimi ende është në vijim, përkatësisht nuk është marrë përgjigje nga PPTH. Shembull drastik është ajo se nuk ka përgjigje në denoncimet penale të paraqitura në PPTH para më se 2 vitesh. Vetëm në 2 prej 3 rasteve të regjistruara është dorëzuar aktakuzë nga PPTH.

#### **Konkluzione:**

- Në suaza të PPDNJ janë paraqitur 22 kallëzime penale kundër PAZ të MPB-së. Në dy nga rastet, Prokuroria publike ka parashtruar akt akuzë;

#### **Objekt i brengosjes:**

- Procedura rreth denoncimeve penale të paraqitura në Prokurorinë publike themelore është afatgjate, stresuese dhe shqetësuese për të quajturat viktime të sjelljes jo të drejtë të policisë. Ende nuk ka përgjigje për denoncimet e paraqitura penale në PPTH para më shumë se 2 vjet.

#### **Rekomandime:**

- Respektim konsekuent i dispozitave të LPP-së sa i përket përfundimit në kohë të hetimit në afat prej 90 ditësh, me qëllim që të mund të ngrihet aktakuzë kundër të quajturve kryerës.
- Sigurimi i pranisë së personave të autorizuar zyrtar në hetim dhe në procedurat gjyqësore kur janë të akuzuar, si dhe kur paraqiten në rolin e dëshmitarit;

# 8

## *Komisioni i Përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*

Projekti për përkrahjen e të drejtave të njeriut ishte i prezantuar para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut më 19.04.2005. Prezantimi u bë nga koordinatori i projektit të PPDNJ. Vlen të përmendet se përfaqësuesi i Komisionit ishte njëri prej prezantuesve në trajnimin e këshilltarëve juridik të përfshirë në PPDNJ, që u mbajt në Mars 2005. Me këtë u vendosën raporte të afërta pune me këtë trup parlamentar.

Duke pasur parasysh se Komisioni i Përhershëm Anketues për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bën pjesë në institucionet shtetërore sferë themelore veprimi i të cilave është problematika e të drejtave të njeriut si dhe faktin që vetëm ky komision parlamentar është vendosur me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, vënia e raporteve me këtë trup parlamentar, ka një rëndësi të madhe.

PPDNJ mori përkrahje politike nga anëtarët e Komisionit. Përkrahje politike projektit nga ky trup parlamentar iu shfaq në formë të konkluzionit në procesverbalin e seancës së komisionit.

Përkundër faktit se ende nuk janë adresuar raste të keqpërdorimit policor në Komisionin e Përhershëm Anketues, anëtarët e këtij Komisioni e lanë të hapur mundësinë që raste të keqpërdorimit policor të prezantohen para tyre po qe se paraqitet nevoja e tillë.

### **Konkluzione:**

- Është vendosur raport pune me Komisionin e Përhershëm Anketues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore

### **Rekomandime:**

- Pas shterjes së mekanizmave të tjera juridike që janë në disponim, raste të caktuara të keqpërdorimit policor të adresohen në Komisionin e përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pas lejes paraprake nga Bordi Ekzekutiv i PPDNJ-së.



# 9

## *Procedura Civile për Kompensim të dëmit*

Me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me LPP është garantuar e drejta e kompensimit të dëmit për viktimat e keqpërdorimit policor. Në të vërtetë, neni 13, paragrafi 2 i Kushtetutës stimulon se personi i cili në mënyrë të paligjshme është privuar nga liria, është arrestuar ose është gjykuar në mënyrë joligjore, ka të drejtë kompensimi të dëmit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj. Më tutje personi i cili në mënyrë joligjore është privuar nga liria, është arrestuar ose dënuar në mënyrë joligjore ka të drejtë kompensimi të dëmit nga mjetet buxhetore, ka të drejtë rehabilitimi si dhe të drejta tjera të përcaktuara me ligj-është theksuar në nenin 11 të LPP.

Prej 100 rasteve të evidentuara të sjelljeve të mundshme jo në rregull nga ana e policisë në kuadër të PPDNJ, vetëm në 15 ka filluar procedurë civile për kompensim dëmi. Vlen të përmendet se njëra prej procedurave për kompensim dëmi ka përfunduar në procedurë të shkallës së parë dhe viktimës (**SK001**) i janë caktuar 120.000 denarë si kompensim dëmi nga gjykata themelore Shkup-1. Për fat të keq procedura ka filluar para më shumë se një dekade, më 1994. Të gjitha procedurat tjera gjenden në gjykatat e shkallës së parë në Maqedoni.

### **Objekt i brengosjes:**

- Procedurat e filluara gjyqësore për kompensim dëmi zgjasin shumë kohë dhe vetëm në një rast ka rezultate të dukshme, përkatësisht është caktuar kompensimi i dëmit.



# 10

## *Vërtetime mjekësore dhe dëshmi të tjera në raste të keqpërdorimit të mundshëm policor*

Dokumenti themelor që shërben si mjet dëshmie në rastet e regjistruara të lëndimeve të mundshme fizike nga ana e përfaqësuesve të policisë është vërtetimi mjekësor. Vërtetimin mjekësor mund ta japë çdo mjek me leje pune dhe me provim të dhënë profesional.

Në vërtetimin mjekësor shkruhen të dhënat e përgjithshme për të së murin, data e dhënies, gjendja momentale shëndetësore e të sëmurit (përshkrim i hollësishëm, madhësia e lëndimit, thellësia, ndryshime në funksione), pastaj vijon diagnoza dhe kualifikimi sipas KP (lëndim trupor dhe të rëndë trupor). Kualifikimi i lëndimit trupor është sipas shkallës së dëmtimit të shëndetit të të sëmurit. Të dhënat që shënohen për rastin, janë ato që mjeku di ti marrë nga i sëmuri. Si problem paraqitet ajo që mjekët shkruajnë çdo gjë e do tu thotë pacienti në lidhje me mënyrën se si i kanë marrë lëndimet.

Në lidhje me vërtetimin mjekësor mjet më i mirë dëshmie janë vërtetimet mjekësore të qendrave mjekësore në vendin tonë, nga vetë fakti se në praktikë paraqiten vërtetime mjekësore me përmbajtje të dyshimtë, të dhëna nga ambulanca private. Po ashtu vërtetimi mjekësor duhet të jepet në kohë, në afat prej një dite pas pësimit të lëndimeve. Sidoqoftë në procedurën para SKBSP-së , zyrës e Avokatit të popullit , Prokurorisë publike, nuk ka dallim mes vërtetimit mjekësor të dhënë nga ndonjë ambulantë private ose nga ndonjë qendër mjekësore deri atëherë kur vërtetimi është plotësuar në mënyrë adekuate.

Në suaza të PPDNJ ka fond nga i cili e quajturave viktimë të veprimit jo në rregull nga policia, u mbulohen shpenzimet për vërtetime mjekësore, nëse bëhet fjalë për raste sociale. Me këtë insistohet që tu ndihmohet rasteve të rrezikuara sociale, si grup jashtëzakonisht e lëndueshme në rastet e keqpërdorimit të mundshëm policor. Është e palejueshme që një qytetar të mos mund t'i realizojë të drejtat e veta për mungesë të mjeteve për ta paguar vërtetimin mjekësor i cili mund të kushtojë deri në 5.000 denarë.

Mjetet tjera dëshmuuese në rastet e PPDNJ janë deklaratat e dëshmitarëve dhe të të quajturave viktimë, fotografi të të quajturës viktimë dhe video regjistrim nga ndodhia.

### **Konkluzione:**

- Në kuadër të PPDNJ ka fond nga i cili të quajturave viktimë të veprimit jo në rregull të policisë u mbulohen shpenzimet për vërtetim mjekësor për rastet sociale;
- Në procedurën para SKBSP-së , zyrës e Avokatit të popullit , Prokurorisë publike, nuk ka dallim mes vërtetimit mjekësor të dhënë nga ndonjë ambulantë private ose nga ndonjë qendër mjekësore nëse vërtetimi është plotësuar në mënyrë adekuate.

## ***Konkluzione të Raportit Përfundimtar***

- Prej 122 të quajturave viktime të regjistruara 52 janë maqedonas, 47 janë shqiptarë dhe 18 janë rom. Shprehur në përqindje, 42,62% të të quajturave viktime janë maqedonas etnik, 38,52% janë shqiptarë etnik, 14,75% janë rom.
- Pjesa dërmuese e viktimave të evidentuara të keqpërdorimit policor janë meshkuj (95,08% të të quajturave viktime), persona madhor (97,54% të të quajturave viktime).
- Numri i përgjithshëm i të quajturave viktime të regjistruara të tejkalimit të autorizimeve të policisë në kuadër të PPDNJ arin 122 që paraqet rritje për 141,8% në krahasim me vitin 2004;
- Numri i rasteve të regjistruara të keqpërdorimit policor dhe të sjelljes jo të drejtë të policisë në kuadër të PPDNJ arrijnë 100, që në raport me 39 rastet e evidentuara në vitin 2004, paraqet një rritje të numrit të rasteve të regjistruara për 156,4%;
- Pjesa më e madhe e rasteve të evidentuara të keqpërdorimit policor vjen nga rajoni i Shkupit, nga rajoni i Kumanovës-Kriva Pallankës, si dhe nga rajoni i Strumicës;
- Viktimat e mundshme kanë frikë të iniciojnë procedurë kundër PAZ të policisë, të cilët i kanë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese dhe ligjore;
- Nëpërmjet takimeve lokale koordinatave mundësohet ndjekja e drejtpërdrejtë efektive e rasteve të regjistruara të keqpërdorimit policor;
- Nëpërmjet takimeve lokale koordinatave përmirësohet qasja e qytetarëve në institucionet e shtetit dhe forcohet lidhja paraprakisht e vendosur në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve të shtetit të cilat pranojnë ankesa për të quajturat shkelje të të drejtave të njeriut;
- Këto takime kanë rëndësi të madhe në procesin e shpejtimit të procedurave që zhvillohen përkitazi me parashtrësat e paraqitura në SKBSP dhe në Zyrën e Avokatit të popullit.
- Në vitin 2005 është arritur mbulim i tërësishëm i Republikës së Maqedonisë nga PPDNJ me përfshirjen e dy OJQ-ve të reja aktive në fushën e të drejtave të njeriut me çka është arritur një qasje e njëjtë në shërbimet që i siguron projekti për të gjithë qytetarët;
- Pjesa dërmuese e rasteve kanë të bëjnë me përzierjen e policëve të uniformuar në rastet e evidentuara të tejkalimit të autorizimeve të policisë;
- Në rajonin e Tetovës dhe Kumanovës rastet e tejkalimit të autorizimeve të policisë dhe veprim të keq, çojnë drejt përzierjes së policëve të uniformuar të cilët punojnë në Sektorin e punëve të brendshme (SPB) Tetovë dhe SPB Kumanovë;
- Në rajonin e Strumicës pjesa dërmuese e rasteve kanë të bëjnë me tejkalime të mundshme nga përfaqësues të Sektorit për tregti të palejuar të SPB Strumicë.
- Rastet e evidentuara të keqpërdorimit policor tregojnë përzierjen e inspektorëve të MPB në numër të konsiderueshëm rastesh;
- Në shtatë raste të ARKA-s është konstatuar përzierje eventuale e një personi-komandimi i mëparshëm i stacionit policor "Rankovce"
- Janë evidentuar raste të përzierjes së forcave speciale policore, si dhe përfaqësues të shërbimeve të zbulimit



- Në suaza të PPDNJ janë regjistruar gjashtë raste të cilat kanë të bëjnë me forcat speciale policore ALFA. Pesë nga të quajturat viktime ankohen në rrahje brutale nga ALFA-t.
- Një nga kryerësit eventual, PAZ i SP Grupçin, OJO Tetovë e ndjek për vepër penale torturë neni 142 paragrafi 1 nga KP;
- Gjatë vitit 2005, për herë të parë nga PPDNJ janë identifikuar raste në të cilat janë përzier përfaqësues të policisë kufitare në kalimet kufitare “Deve Bair”, “Tabanovcë” dhe “Bogorodicë”;
- Parashtresat për sjellje jo në rregull të policisë mund të paraqiten te Sektori i MPB-së dhe te inspektorët e detashuar të Sektorit në 8 qytete në Maqedoni;
- Personeli që punon në implementimin e projektit vendosi praktikën e paraqitjes së kërkesave për njoftim në SKBSP për raste kur nuk është vepruar për ndonjë parashtresë të caktuar në kohën e paraparë për veprim sipas parashtresës së paraqitur;
- Dënimi i vetëm që u është shqiptuar PAZ të MPB për të cilët është konstatuar se kanë tejkaluar autorizimet e tyre me shkeljen e të drejtave të qytetarëve, paraqet sanksioni administrativ- 15% të rrogës mujore në kohëzgjatje prej 1 deri në gjashtë muaj;
- Nga gjithsej 71 parashtresa të O.P. të OJQ-ve të cilat implementojnë PPDNJ është parë përgjigje për gjithsej 47. Nga ato është konstatuar tejkalim i autorizimeve të policisë në gjithsej 9 raste.;
- Numri i të punësuarve në Sektor, të cilët veprojnë sipas parashtresave të paraqitura, është konstant vite me radhë, edhe pse numri i parashtresave të paraqitura në Sektor është shumëfishuar.
- Në 15 nga parashtresat për të cilat është marrë përgjigje, Avokati i popullit nuk ka konstatuar shkelje të të drejtave ligjore dhe kushtetuese të qytetarëve, ndërsa në pesë raste nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprimesh sipas nenit 20 paragrafi 7 nga Ligji për Avokatin e popullit (afat i kaluar prej një viti nga shkelja e bërë). Përgjigje është marrë për 33 nga gjithsej 51 parashtresa të paraqitura;
- Me hapjen e zyrave rajonale të Avokatit të popullit në gjashtë qytete të Maqedonisë dukshëm është lehtësuar qasja e të quajturave viktime të keqpërdorimit policor dhe në përgjithësi të gjithë qytetarëve deri te ky institucion relevant, në nivel lokal;
- Në suaza të PPDNJ janë paraqitur 22 kallëzime penale kundër PAZ të MPB-së. Në dy nga rastet, Prokuroria publike ka parashtruar akt akuzë;
- Është vendosur raport pune me Komisionin e Përhershëm Anketues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;
- Në kuadër të PPDNJ ka fond nga i cili të quajturave viktime të veprimit jo në rregull të policisë u mbulohen shpenzimet për vërtetim mjekësor për rastet sociale;
- Në procedurën para SKBSP-së , zyrës e Avokatit të popullit , Prokurorisë publike, nuk ka dallim mes vërtetimit mjekësor të dhënë nga ndonjë ambulantë private ose nga ndonjë qendër mjekësore nëse vërtetimi është plotësuar në mënyrë adekuate.

## ***Objekt i brengosjes***

- Sistemi i hetimit të ankesave lidhur me tejkalimin e autorizimeve të policisë nuk është transparent, në kohë, i plotë dhe objektiv në atë masë që është e domosdoshme për një shoqëri demokratike evropiane.;
- Procedura rreth denoncimeve penale të paraqitura në Prokurorinë publike themelore është afatgjate, stresuese dhe shqetësuese për të quajturat viktime të sjelljes jo të drejtë të policisë. Ende nuk ka përgjigje për denoncimet e paraqitura penale në PPTH para më shumë se 2 vjet.;
- Procedurat e filluara gjyqësore për kompensim dëmi zgjasin shumë kohë dhe vetëm në një rast ka rezultate të dukshme, përkatësisht është caktuar kompensimi i dëmit.;
- Një numër i konsiderueshëm qytetarësh, të quajtura viktime të sjelljes jo në rregull të policisë, u drejtohen këshilltarëve juridik të PPDNJ-së duke kërkuar ndihmë dhe këshilla juridike, megjithatë të njëjtën frikohen të iniciojnë procedurë kundër PAZ të MPB;
- Në rast të konstatimit të tejkalimeve të autorizimeve nga ndonjë PAZ i policisë, paraqitësi i parashtresës nuk njoftohet për atë se cili sanksion i është shqiptuar PAZ-it, kryerës i veprës. Aq më tepër bazë për këtë sjellje jo transparente të Sektorit është neni 23, paragrafi 2 pika 4. të Rregullores për kryerjen e punëve të Sektorit<sup>8</sup>. Dispozita nga Rregullorja është në kundërshtim me nenin 124 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë<sup>9</sup>;
- Në një pjesë të rasteve të regjistruara të të quajturit keqpërdorim policor, policia ka bërë denoncime penale dhe për kundërvajtje kundër të quajturave viktime.
- Me propozimligjin e policisë që në nëntor të vitit 2005 është në procedurë të miratimit parashihet afat prej 30ditësh nga dita e ngjarjes në të cilin qytetari mund të paraqesë parashtresë në polici. OJQ-të që implementojnë PPDNJ janë të mendimit se afati prej 30 ditësh që propozohet është restriktiv për të drejtat e njeriut;
- Periudha kohore gjatë së cilës Sektori i MPB vepron lidhur me parashtresat e paraqitura për tejkalimin e autorizimeve të Policisë ose për veprim të keq është propozim dhe nuk korrespondon me afatet e caktuara në Rregulloren e punës të Sektorit;
- Përfaqësuesit e Sektorit nuk i njoftojnë me shkrim paraqitësit e parashtresave për rrjedhën e procedurës e as që informohen paraqitësit e parashtresave për arsyet e kalimit të afatit prej 30 ditësh ndonëse për këtë janë të detyruar me nenin 17 paragrafi 4 dhe nenin 24 të Rregullores për kryerjen e punëve në Sektor.;

---

<sup>8)</sup> Paraqitësi i parashtresës do të informohet a është marrë masë disiplinore kundër kryerësit pa u përmendur lloji i masës .

<sup>9)</sup> Neni 24 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë shënon: “Çdo qytetarë ka të drejtë të paraqesë parashtresë në organet shtetërore dhe në shërbimet tjera publike dhe për to të marrë përgjigje”.

---

## *Rekomandime të Raportit përfundimtar*

### **Rekomandime për Qeverinë e Republikë së Maqedonisë:**

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë ta shqyrtojë mundësinë e vendosjes së organit të pavarur të jashtëm për shqyrtimin e parashtresave lidhur me tejkalimin e autorizimeve nga policia, në përputhje me *Standardet e Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut*;

### **Rekomandime për Ministrinë e punëve të brendshme:**

- Sektori i MPB-së duhet ti shmanget çdo zgjatjeje të panevojshme të zgjidhjes së rasteve lidhur me keqpërdorimin policor;
- MPB-ja të ndërmarrë masa me qëllim të sigurimit të hetimit të plotë, objektiv, transparent dhe në kohë nga ana e Sektorit rreth parashtresave të paraqitura lidhur me tejkalimin e autorizimeve të policisë ose sjelljes së keqe;
- Viktimat të informohen në kohë për ecurinë dhe zgjatjen e procedurës së pas parashtresës së paraqitur
- Sigurimi i pranisë së personave të autorizuar zyrtar në hetim dhe në procedurat gjyqësore kur janë të akuzuar, si dhe kur paraqiten në rolin e dëshmitarit;
- Riekipimi kadrovik i Sektorit me qëllim që i njëjti të mund të veprojë rreth parashtresave të paraqitura në përputhje me afatet e parapara me Rregulloren e punës së Sektorit;
- Të ngrihet iniciativë në Ministrinë e punëve të brendshme për ndryshimin e nenit 23 paragrafi 2 pika 4 të rregullores për kryerjen e punëve të Sektorit dhe për shtimin e dispozitës në nenin e përmendur me të cilën Sektori do të obligohej që viktimat e sjelljes jo të drejtë të policisë të informohen për masat e ndërmarra kundër PAZ të Policisë në evidentimin e rasteve të keqpërdorimit policor;
- Të ngrihet iniciativë në Ministrinë e punëve të brendshme dhe në Sindikatën e Policisë maqedonase për shlyerjen e nenit 138 të marrëveshjes Kolektive të MPB-së me të cilin i jepet e drejta Ministrit që dorëheqjen e të punësuarit ta zëvendësojë me dënim me të holla;

### **Rekomandime për Avokatin e Popullit:**

- Të ndërmerret iniciativë për ndryshime dhe plotësimet e paralajmëruara të Ligjit për Avokatin e popullit me të cilën do të inkuadrohet dispozita në tekstin ligjor, me të cilën do të parashihet afat gjatë të cilit Avokati i popullit do të jetë i obliguar të përfundojë procedurën e parashtresës së paraqitur, si dhe mekanizëm për njoftim periodik të qytetarëve për gjendjen e parashtresës së paraqitur për të cilën nuk është marrë përgjigje në afatin e paraparë ligjor.
- Shfrytëzim ekstensiv i dispozitës së nenit 25, paragrafi 2 nga Ligji për Avokatin e Popullit. Kjo dispozitë e autorizon A.P. në rastin kur është konstatuar shkelje e të drejtave dhe obligimeve ligjore, shpjegim të rastit përmes mjeteve të informimit publik me shpenzime të organit që ka bërë shkelje (në këtë rast MPB);

- Zbatim ekstensiv i nenit 30, paragrafi 1, me të cilën Avokatit të popullit i jepet autorizim të ngrejë iniciativa për ndryshime dhe plotësime të ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore të propozuesit e autorizuar, kurse në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë punën e policisë.

#### **Rekomandime për gjyqësinë:**

- Respektim konsekuent i dispozitave të LPP-së sa i përket përfundimit në kohë të hetimit në afat prej 90 ditësh, me qëllim që të mund të ngrihet akt akuzë kundër të quajturve kryerës.

#### **Rekomandime për punën e PPDNJ në të ardhmen:**

- Mbajtja e rregullt e takimeve lokale koordinatave një herë në muaj në vitin 2006 me qëllim të thellimit dhe intensifikimit të bashkëpunimit të PPDNJ-së, OJQ-ve dhe institucioneve shtetërore që pranojnë ankesa për të quajturat shkelje të të drejtave të njeriut.;
- Zbatimi i fushatës intensive në medime me qëllim të njohjes së qytetarëve me shërbim që u ofron projekti të quajturave viktime të sjelljes jo të drejtë të policisë;
- Pas shterjes së mekanizmave të tjera juridike që janë në disponim, raste të caktuara të keqpërdorimit policor të adresohen në Komisionin e përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pas lejes paraprake nga Bordi Ekzekutiv i PPDNJ-së.;



Organization for Security and Co-operation in Europe

**Spillover Monitor**  
**Mission to Skopje**